



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 55

Tiranë – E premte, 19 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 46/2019, datë 11.4.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 4441
Rezolutë e Kuvendit datë 11.4.2019	Mbi progresin e Shqipërisë në procesin e Integritetit në Bashkimin European përgjatë vitit 2018..... 4441
Rezolutë e Kuvendit datë 11.4.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018..... 4442
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 17.4.2019	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2019..... 4445
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 231, datë 17.4.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Pallati me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja””..... 4445
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 234, datë 17.4.2019	Për programin e integruar të zhvillimit “Poli i Drejtësisë”..... 4454
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 173, datë 12.4.2019	Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë..... 4459
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 4, datë 17.4.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm””..... 4472
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 3.4.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”..... 4475

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 3.4.2019	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019 për shoqërinë OST sh.a.....	4476
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 3.4.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2019.....	4479
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 3.4.2019	Mbi fillimin e procedurës për transpozimin e rregullores 2017/459, të miratuar me vendimin nr. 2018/06/PHGL-EnC, “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”.....	4481

**VENDIM**
Nr. 46/2019**PËR DISA NDRYSHIME NË**
VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017,
“PËR ÇAKTIMIN E ANËTARËSISË SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktohen deputetët Alban Zeneli (PD), Adriatik Alimadhi (PD), Korab Lita (PD), Aurora Mara (LSI) dhe Elda Hoti (LSI).

2. Në Komisionin për Integrimin European caktohen deputetët Ediola Braha (LSI) dhe Ralf Gjoni (LSI).

3. Në Komisionin për Politikën e Jashtme caktohen deputetët Ligoraq Karamelo (PD) dhe Edlira Hyseni (LSI).

4. Në Komisionin për Sigurinë Kombëtare caktohen deputetët Lefter Maliqi (PD), Edmond Rrushi (LSI) dhe Ylli Shehu (LSI).

5. Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat caktohen deputetët Arben Elezi (PD) dhe Amra Barova (LSI).

6. Në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktohen deputetët Halil Jakimi (PD), Arlind Çaçani (PD) dhe Nimet Musaj (LSI).

7. Në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë caktohen deputetët Majlinda Halilaj (PD) dhe Enver Roshi (LSI).

8. Në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik caktohet deputetja Enada Kapllani (LSI).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz RUÇI

Miratuar më datë 11.4.2019

REZOLUTË**MBI PROGRESIN E SHQIPËRISË NË**
PROCESIN E INTEGRIMIT
NË BASHKIMIN EUROPIAN
PËRGJATË VITIT 2018

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, dhe të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

- Nxitur nga vullneti dhe mbështetja e plotë e qytetarëve shqiptarë për anëtarësimin e merituar të Shqipërisë në Bashkimin European;

- Me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi European dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave të ndërmarra për konsolidimin e shtetit të së drejtës, forcimin e institucioneve dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

- Duke marrë në konsideratë rekomandimin e pakushtëzuar të Komisionit European për hapjen e negociatave të anëtarësimit, bazuar mbi përparimin e arritur nga Shqipëria në përmbushje të çështjeve parësore të përcaktuara nga Komisioni European;

- Duke marrë në konsideratë përfundimet e Këshillit European të qershorit 2018, në të cilat Këshilli ra dakord që t'i përgjigjej pozitivisht përparimit të Shqipërisë dhe përcaktoi rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor 2019;

- Duke marrë në konsideratë vijimin dhe thellimin e mëtejshëm të përparimit të vendit në procesin e integrimit në Bashkimin European, reflektuar në zbatimin efektiv të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit European për hapjen e negociatave të anëtarësimit;



- Duke marrë në konsideratë reformat e ndërmarra në kuadër të përmbushjes së kriterit politik të Kopenhagenit, si reforma në drejtësi dhe reforma të tjera në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

- Duke marrë në konsideratë rëndësinë e funksionimit të duhur të Kuvendit mbi bazën e dialogut konstruktiv politik për përparimin e Shqipërisë në procesin e integritetit europian;

- Duke rikonfirmuar se hapja e negociatave dhe anëtarësimi me të drejta të plota në Bashkimin Europian është qëllimi strategjik kombëtar i Shqipërisë, si një vend që synon konsolidimin e demokracisë, respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të bashkëpunimit reciprok, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë funksionale të tregut, të cilat përbëjnë vlerat e përbashkëta mbi të cilat është themeluar Bashkimi Europian;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Rikonfirmon se anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është objektivi madhor i vendit dhe kryeson agjendën e tij kombëtare.

2. Konfirmon qasjen e tij se përparimi në procesin e integritetit europian të Shqipërisë bazohet në hartimin dhe zbatimin e reformave transformuese dhe të pakthyeshme.

3. Vlerëson mbështetjen që Bashkimi Europian dhe vendet anëtare kanë dhënë për Shqipërinë, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës, forcimit të institucioneve dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

4. Thekson se dialogu konstruktiv ndërpartiak brenda institucioneve kushtetuese është thelbësor për procesin e integritetit në BE.

5. Thekson rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të përfshirjes dhe rolit të shoqërisë civile në procesin integruar të vendit.

6. Vlerëson progresin e arritur përgjatë vitit 2018 në përmbushjen e detyrimeve, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe plotësimin e rekomandimeve për hapjen e negociatave të anëtarësimi.

7. I kërkon Qeverisë të konsolidojë reformat e arritura dhe të vijojë të thellojë më tej reformat për plotësimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim.

8. I kërkon Qeverisë Shqiptare të ruajë dhe të forcojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të marrë pjesë në nismat rajonale, si dhe të zbatojë angazhimet në kuadër të Procesit të Berlinit.

9. Angazhohet që të forcojë dhe të përmirësojë më tej aktivitetin e organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integritetit europian, si Komisioni i Integritetit Europian dhe Këshilli Kombëtar për Integritetin Europian, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integritetit europian.

10. Angazhohet të garantojë dhe të fuqizojë integritetin dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

11. Angazhohet të vazhdojë të shqyrtojë me përparësi dhe në një proces të gjerë konsultimi kuadrin ligjor që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian, si dhe të gjitha nismat të cilat janë pjesë e agjendës reformuese të integritetit të Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën e vendit, konventat ndërkombëtare dhe *acquis-in* e Bashkimit Europian.

12. Mbi bazën e arritjeve në plotësimin e përparësive kyçe, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i kërkon Këshillit Europian që të miratojë hapjen zyrtare të bisedimeve të anëtarësimi me Shqipërinë në këtë fazë të rëndësishme të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe vazhdimin të mëtejshëm të reformave në vend.

Miraturar më datë 11.4.2019

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar qëllimin dhe misionin e punës së institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për promovimin e një shoqërie me mundësi dhe shanse të barabarta



e duke luftuar çdo veprim apo mosveprim që sjell diskriminim;

- Duke inkurajuar dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili ka për mision garantimin për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;

- Duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, me shoqërinë civile, median dhe publikun;

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2018, dhe konstaton se:

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është angazhuar në mënyrë aktive për shqyrtimin e ankesave të adresuara drejtpërdrejt institucionit, të referuara nga individët apo palët e interesuara, duke rritur numrin e rasteve të trajtuara dhe duke zgjeruar tipologjinë e tyre.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar një numër më të lartë ankesash krahasuar me vitin paraardhës. Çështjet e shqyrtuara me pretendim diskriminim, në numër më të lartë, i përkasin fushës së të mirave dhe shërbimeve dhe fushës së punësimit, sipas fushave të veprimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Në analizë të të dhënave të raportuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vihet re një numër më i lartë i ankesave drejtuar subjekteve publike, krahasuar me subjektet private me objekt “përshtatjen e arsyeshme të banesave sociale, institucioneve publike, apo përfitimin e shërbimeve publike”. Një vlerësim në rritje kanë regjistruar rastet e ankesave për shkak të gjinisë, ndërsa ankesat për shkak të aftësisë së kufizuar, orientimit seksual dhe identitetit gjinor vijnë të mbeten në numër të ulët.

- Hetimet administrative, të nisura kryesisht nga Zyra e Komisionerit, si instrument për identifikimin e rasteve të diskriminimit, janë pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2017.

- Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesave, konstatohet rritje e numrit të vendimeve të marra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe shtimin e rasteve të konstatuara në cenim të parimeve të barazisë dhe që rezultojnë në diskriminim.

- Në analizë të numrit të rasteve të raportuara, numri i vendimeve të marra me konstatim mosdiskriminimi është më i lartë në raport me vendimet me konstatim diskriminimi. Vendimet e marra me “konstatim diskriminimi” për shkak të racës dhe aftësisë së kufizuar mbeten në numër të ulët.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë rekomandime për projektligje dhe akte nënligjore, me synim përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me kuadrin ligjor në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. KMD, në ushtrim të funksioneve ligjore, ka dhënë rekomandime për çështje të veçanta drejtuar disa institucioneve shtetërore.

- Ka një rritje të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi në gjykata, për sa i përket vendimeve gjyqësore që kanë lënë në fuqi vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por edhe rritjen e numrit të vendimeve gjyqësore për pranimin e padive, duke konstatuar diskriminim dhe dhënien e dëmshpërblimit.

- Me ndryshimet e strukturës dhe organikës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të miratuara nga Kuvendi gjatë vitit 2018, u bë e mundur rritja e kapaciteteve administrative të institucionit, me një shtesë prej 11 punonjësish, si dhe u mundësua prezenca e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me 3 zyrat rajonale, përkatësisht në qytetet Korçë, Shkodër dhe Fier.

- Në datën 29 tetor 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka organizuar Konferencën e Tretë Rajonale të Institucioneve të Barazisë, me temë “Pavarësia e institucioneve të barazisë”, ku morrën pjesë organet e barazisë së Europës Juglindore, duke rritur rolin dhe vizibilitetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nivel rajonal.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka pasur një rol më proaktiv në media, me qëllim informimin e opinionit publik me veprimtarinë e institucionit, duke rritur numrin e prononcimeve publike të Komisionerit në median vizive, të shkruar, si dhe të pasqyruara edhe në faqen zyrtare të institucionit në rrjetin social. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka kushtuar vëmendje të veçantë promovimit të praktikave të mira institucionale në televizione kombëtare.



- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është angazhuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të opinionit publik, me qëllim informimin mbi njohjen e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, rolin e Komisionerit, përmes zhvillimit dhe pjesëmarrjes në aktiviteteve ndërgjegjëse në disa qytete të vendit, duke përfshirë disa target grupe si: punonjësit e sektorit të arsimit, të bashkive, që mbulojnë shërbimet sociale, mbrojtjen e vajzave dhe grave nga dhuna, me bazë gjinore, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, punonjësit e zyrave rajonale të punës, përfaqësues të OJF-ve.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë pjesë e një sërë aktiviteteve institucionale, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, organizatat vendase dhe të huaja që punojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është angazhuar në hartimin e raporteve, raportimeve në kuadrin e organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë, si dhe në procesin e integritetit evropian.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2019, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

- Të rrisë rolin monitorues të institucionit në drejtim të zbatimit dhe respektimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, duke pasqyruar gjetjet e monitorimit në raporte të veçanta.

- Të forcojë rolin proaktiv të institucionit, të garantojë se çdo ankesë drejtuar institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të trajtohet në kohë dhe me efektivitet, duke mundësuar zbatimin efektiv të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Të rrisë iniciativat hetimore *ex officio* në rastin e shkeljes së të drejtave të njeriut mbi baza diskriminimi, duke fuqizuar monitorimin dhe duke rritur kapacitetet e stafit të tij për identifikimin e çështjeve *ex officio*.

- Të garantojë pjesëmarrje aktive dhe fuqizimin institucional nëpërmjet rritjes së numrit të rasteve/çështjeve gjyqësore, duke pasqyruar domosdoshmërinë institucionale dhe zgjerimin e grupeve përfituese, në përmbushje të qëllimit dhe objektit të ligjit.

- Të identifikojë dhe të propozojë ndryshime dhe përmirësime ligjore të kuadrit rregullator në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, që rrjedhin prej punës kërkimore dhe analizave të thelluara dhe krahasimore të çështjeve të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Të forcohet roli i institucionit në rajonet ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka zyrat rajonale, për të zgjeruar aktivitetet gjithëpërfshirëse ndërgjegjëse dhe informuese, jo vetëm në zonat urbane, por edhe në ato rurale, me qëllim promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim.

- Të rrisë numrin e rekomandimeve drejtuar institucioneve publike dhe sektorit privat në drejtim të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Të fuqizojë bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore, në shkëmbimin e raporteve tematike, në identifikimin e çështjeve përfaqësuese dhe në advokimin për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe me shanse të barabarta.

- Të realizojë monitorimin e aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në fushën e punësimit, arsimit dhe të mirave e shërbimeve dhe të paraqesë një raport të veçantë në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mbi rezultatet e monitorimit të aksesueshmërisë.

- Të paraqesë një raport të veçantë në lidhje me diskriminimin e fëmijëve për Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

- Të bashkëpunojë me median, si burim i mundshëm informacioni, për promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të luftuar dhe parandaluar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, homofobinë, ksenofobinë, racizmin në media dhe si partner në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Miraturar në datën 11.4.2019

KRYETARI
Gramoz Ruçi



VENDIM
Nr. 215, datë 17.4.2019

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND EDHE PËR KANDIDATË TË
TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE
PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 27, dhe të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Përjashtimisht, për vitin 2019, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND është e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2019, pranimi në TND të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 8 (tetë).

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil, janë, si më poshtë vijon:

a) Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

b) Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

c) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlefshme në:

- institucione të administratës publike;
- institucione bankare të nivelit të dytë e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë të paktën 5 (pesë) vjet që janë krijuar.

Përjashtimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë:

- në institucione ndërkombëtare brenda vendit;
- në profesion jashtë vendit;
- pedagogë në institucione të arsimit të lartë;
- avokatë, noterë apo kontabilistë të miratuar brenda ose jashtë vendit,

duhet të kenë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune, përkatësisht në këto institucione ose në profesion.

ç) Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative, të cilat janë në proces, si dhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

5. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 231, datë 17.4.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “PALLATI ME SHIGJETA –
RRETHRROTULLIMI “SHQIPONJA””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit



nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Pallati me shigjeta - rrethrotullimi “Shqiponja””.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “tokë arë” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 224 874 430.42 (një miliard e dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë pikë dyzet e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 224 874 430.42 (një miliard e dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë pikë dyzet e dy) lekësh, për pasuritë e llojit “truall”, “tokë arë” dhe “ndërtesë”, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët, e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

10. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e aktit pa tarifa regjistrimi.

11. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "Rehabilitimi i segmentit rrugor "Pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja""

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT sipas zvrpp				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË										VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME		
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Shpronësim tokë “arë”			Shpronësi m tokë “truall”		Vlera (lekë)	Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jo banimi			Ndërtesë së total	
								Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)				Sip.Ndërt. konf. ZVRPP (m2)	Çmimi mes. sh/blerje ve sipas zvrpp (l/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2)				Vlera sipas Preventivit (lekë)
1	Bashkim Ilia Agim Albert Anesti Estref Genci Perihan Llazar	Ramazan Niko Lutfi Spiro Llambi Fadil Muhedin Izet Lefter	Sinani Dado Çarçani Gulo Kondakçiu Durrsi Shahu Zoto Veshi	8310	12/19	Truall	3934.66				1283	31219	40053977							40,053,977	Konf. ZVRPP
2	Reiz	Zihni	Gjoni	8310	12/121-Nd	Ndërtese	73.6							73.6	70000	5152000			73.6	5,152,000	Konf. ZVRPP, Kufizim në favor të Raiffeisen Bank,
3	Reis	Zihni	Gjoni	8310	12/293	Truall	200				200	31219	6243800							6,243,800	Konf. ZVRPP, Kufizim në favor të Raiffeisen Bank,
4	Përparim Merita Ermira	Shaban Abdulla Sherif	Canameri Çelmeta Agolli	8310	12/21	Truall, Ndërtese	922				406	31219	12674914				794	5,618,132	794	18,293,046.14	Konf. ZVRPP
5	Agim Engjell Qemal Shefki	Aleks Iljaz Ali Abdulla	Spiro Bejleri Berami Shijaku	8310	12/22	Truall	1300				49	31219	1529731							1,529,731	Konf. ZVRPP
6	Anton		Gjinaj	8310	12/115	Truall	1337				25	31219	780475							780,475	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të ProCredit Bank
7	Natasha	Nazif	Dervishaj	8310	12/153	Truall, Ndërtese	32.6				32.6	31219	1017739.4				25.7	769,337	25.7	1,787,076.4	Konf. ZVRPP
8	Sefedin		Bitri	8310	12/116	Truall	850				78	31219	2435082							2,435,082.00	Konf. ZVRPP
9	Alma	Qazim	Shalsi	8310	10/169	Truall, Ndërtese	1627				379	31219	11832001				40	21,689,943	40	33,521,944.00	Konf. ZVRPP, Kufizime ne seksionin E te karteles
10	Colombo II shpk Veko shpk			8310	12/298	Truall	6000				60	31219	1873140							1,873,140.00	Konf. ZVRPP
11	Besnik	Adem	Doçi	8210	7/521	Truall, Ndërtese	254				254	38614	9807956	167.52	65000	10888800	48	1,370,882.00	215.52	22,067,638.00	Konf. ZVRPP
12	Besnik	Adem	Doçi	8210	7/522	Truall, Ndërtese	230.1				24.7	38614	953765.8	151.48	65000	9846200	70.7	2,019,197.00	222.18	12,819,162.80	Konf. ZVRPP
13	Petrut	Nezir	Selmani	8210	7/418	Truall	174				174	38614	6718836							6,718,836.00	Konf. ZVRPP
14	Fatri	Nezir	Selmani	8210	7/419	Truall	174				174	38614	6718836							6,718,836.00	Konf. ZVRPP



																			0	
15	Hysen	Zyhdë	Saraçi	8210	7/503	Truall	805.6				246	38614	9499044						9,499,044.00	Konf. ZVRPP
	Pëllumb	Zyhdë	Saraçi																	
16	Lajana	Pandeli	Kuli	8210	7/498	Truall	616.3				87	38614	3359418						3,359,418.00	Konf. ZVRPP
	Gjovalin	Pjetër	Kuli																	
17	Gjovalin	Pjetër	Kuli	8210	7/474	Truall, Ndertese	530.2				241	38614	9305974				230	3,731,287	13,037,261.00	Konf. ZVRPP
18	Dashi	Alo	Satko	8210	7/476	Truall	378				149	38614	5753486						5,753,486.00	Konf. ZVRPP, Gjurma e shpronësimit prej edhe njesine e sherbimit, per te cilen nuk jane hedhur te dhenat ne table, pasi grupit te vleresimit nuk i jane lejuar matjet.
19	Erjon	Dashi	Satko	8210	7/475	Truall	1422				411	38614	15870354						15,870,354.00	Konf. ZVRPP
20	Uke	Idriz	Celkolaj	8210	7/46	Truall	300				300	38614	11584200						11,584,200.00	Konf. ZVRPP
21	Albert		Lalo	3866	215/136	Truall, Ndertese	214.3				214.3	4242	909060.6	225	53500	12037500		225	12,946,560.60	Konf. ZVRPP, Barre Hipotekore favor te Alpha Bank + Sekuestro Konservative
22	Bashkëpronaret sipas certifikates se pronese			3866	301/217	Are	11148	2889	448	1294272									1,294,272.00	Konf. ZVRPP, kufizim ne favor te shoqërisë Romario
23	Renis	Kastriot	Revaj	3866	305/127	Are	1206	102	448	45696									45,696.00	Konf. ZVRPP
24	Kujtim		Hyka	3866	305/76	Are	2362	628	448	281344									281,344.00	Konf. ZVRPP
25	Shyqyri	Sulo	Sulaj	3866	305/70	Are	562	491	448	219968									219,968.00	Konf. ZVRPP
26	Jashar	Bajram	Poçi	3866	306/168	Are	1025	1025	448	459200									459,200.00	Konf. ZVRPP
27	Mustafa	Novruz	Taçi	3866	306/352	Truall	270				270	4242	1145340						1,145,340.00	Konf. ZVRPP, Hipotekim ne favor te BKT, Gjurma e shpronësimit prej edhe njesine e sherbimit, per te cilen nuk jane hedhur te dhenat ne table, pasi grupit te vleresimit nuk i jane lejuar matjet.
28	Dritan	Xhem		3866	306/353	Are	130	130	448	58240									58,240.00	Konf. ZVRPP
29	Engjellushe Astrit	Zenel Zaim	Poçi Ibro	3866	306/166	Are	4383	1232	448	551936									551,936.00	Konf. ZVRPP
30	Hamdi	Osman	Bixhaku	3866	306/208	Are	2830	351	448	157248									157,248.00	Konf. ZVRPP
31	Agron Voete Dhurata Robert Lirije Redi Oriana Ajete Enis Sami		Zuku Savali Sulstarova Çabej Elezi Sulstarova Sulstarova Sulstarova Sulstarova	3866	306/209	Truall	5200				1280	4242	5,429,760						5,429,760.00	Konf. ZVRPP
32	Dritan	Fako	Llanaj	3866	315/43	Are	725	364	448	163072									163,072.00	Konf. ZVRPP
33	Fredi	Bajram	Mustafaj	3866	315/123	Are	200	12	448	5376									5,376.00	Konf. ZVRPP



34	Shëfkat	Ibrahim	Stafa	8210	7/484	Truall	1737				1120	38614	43,247,680						43,247,680.00	Konf. ZVRPP	
	Sabrije	Ibrahim	Stafa																		
35	Aishe Hysen Pellumb		(Llagami) Saraçi Saraçi Saraçi	8210	7/493	Truall	803.8				385	38614	14,866,390						14,866,390.00	Konf. ZVRPP	
36	Aishe Hysen Pellumb		(Llagami) Saraçi Saraçi Saraçi	8210	7/500	Truall	1946				1249	38614	48,228,886						48,228,886.00	Konf. ZVRPP	
37	Aishe Hysen Pellumb	Zyhdë Zyhdë Zyhdë	Llagami Saraçi Saraçi	8210	7/413	Truall	400				143	38614	5,521,802						5,521,802.00	Konf. ZVRPP	
38	Bashkëpronarët		Shijaku Tafaj Kelmendi Brahma Hallulli Ahmeti Aliaj Bastari	8210	7/258	Truall	60				60	38614	2,316,840						2,316,840.00	Konf. ZVRPP	
39	Ramazan Nezir		Selmani	8210	7/415	Truall	19				19	38614	733,666						733,666.00	Konf. ZVRPP	
40	Bashkëpronarët		Hallulli Shijaku Tafaj Brahma Kelmendi Ahmeti Bastari Aliaj	8210	7/465	Truall	13398.6				469	38614	18,109,966						18,109,966.00	Konf. ZVRPP	
41	Kujtim	Nezir	Selmani	8210	7/417	Truall	347				227	38614	8,765,378						8,765,378.00	Konf. ZVRPP	
42	Ylli	Nezir	Selmani	8210	7/432-N1	Ndërtesë	42.2								42.2	1,520,537	42.2		1,520,537.46	Konf. ZVRPP	
43	Ylli	Nezir	Selmani	8210	7/432	Truall	355.6				125	38614	4,826,750						4,826,750.00	Konf. ZVRPP	
44	Aishe Hysen Pellumb	Zyhdë	Llagami Saraçi Saraçi	8210	7/519	Truall	721				203	38614	7,838,642						7,838,642.00	Konf. ZVRPP	
45	Shoqëria Railing Shpk			8210	7/523	Truall Ndërtesë	99.5				91	38614	3,513,874	81.6	65000	5304000	113.4	6,709,873.46	195	15,527,747.46	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Fondi Besa
46	Shoqëria Railing Shpk			8210	7/524	Ndërtesë	126.3										193	11419804.54	193	11,419,804.54	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Fondi Besa
47	Sose Uke Elira Besnik	Syle Idriz Idriz Idriz	Çelkolaj Çelkolaj Çakraj Çelkolaj	8210	7/44	Truall	300				100.7	38614	3,888,430						3,888,429.80	Konf. ZVRPP	
48	Halil	Muj	Muja	8210	7/45	Truall	287.6				12	38614	463,368						463,368.00	Konf. ZVRPP	
49	Gjolek	Islam	Mala	3866	315/104	Truall	780				156	4242	661,752						661,752.00	Konf. ZVRPP	
50	Ndue	Frang	Marinaj	3866	315/662	Truall Ndërtesë	303				303	4242	1,285,326				392	16,393,059.76	392	17,678,385.76	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank.
51	Ndue	Frang	Marinaj	3866	315/663	Truall Ndërtesë	813				141	4242	598,122				398.5	16,664,887.24	392.5	17,263,009.24	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank.
52	Frang	Dede	Marinaj	3866	315/654	Truall Ndërtesë	244.7				20	4242	84,840	183	53500	9790500			183	9,875,340.00	Konf. ZVRPP
53	Frang	Dede	Marinaj	3866	315/653	Truall	134				134	4242									



													568,428							568,428.00	
54	Nezir	Ismail	Hysneli	3866	315/86	Are	2000	660	448	295680										295,680.00	Konf. ZVRPP
55	Nezir	Ismail	Hysneli	3866	315/89	Are	500	121	448	54208										54,208.00	Konf. ZVRPP
56	Flori	Asqeri	Protoduari	3866	315/546	Truall Ndërtesë	474				292	4242	1,238,664	227.2	53500	12155200		453.9	13,393,864.00	Konf. ZVRPP, Gjurma e shpronësimit prej objektit e kombinuar, për të cilën nuk janë hedhur të dhënat në tabele, pasi grupit të vlerësimit nuk i janë lejuar matjet.	
57	Shkelqim		Saraçi	3866	305/309	Truall	326.2				23	4242	97,566							97,566.00	Konf. ZVRPP
58	Gani	Rexhep	Brahimaj	3866	301/217-Nd-4	Ndërtesë	94.6							131.8	53500	7051300	80.7	2,853,782	212.5	9,905,082.27	Konf. ZVRPP
59	Besim	Qamil	Brahimaj	3866	305/293	Truall Ndërtesë	300.1				215	4242	912,030	158.5	53500	8479750	108	3,632,379	266.5	13,024,159.34	Konf. ZVRPP
60	Sazan	Etem	Alimadhi	3866	301/119	Are	270	96	448	43008										43,008.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të shoq.Bogova
61	Adriatik Bajram	Selamet	Xurre Hoxhallari	3866	301/166	Are	1270	457	448	204736										204,736.00	Konf. ZVRPP
62	Bonipacio		Di Francesko	3866	315/208	Are	700	395	448	176960										176,960.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Merkaj shpk
63	Marjush	Kujtim	Mulleti	3866	315/630	Are	1000	138	448	61824										61,824.00	Konf. ZVRPP
64	Elton	Shahin	Shehu	3866	215/200-Nd	Ndërtesë	69										156.5	4,657,505	156.5	4,657,505.00	Konf. ZVRPP, Kufizime në seksionin E të karteles
65	Artan	Ismet	Caushi	3866	306/257	Truall Ndërtesë	547				547	4242	2,320,374				916.1	27,134,529.3	916.1	29,454,903.30	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të BKT
66	Abedin	Kasëm	Dyrmishi	3866	315/609/2	Arë, Truall Ndërtesë	110	14	448	6272	87	4242	369,054	214.2	53500	11459700	87	2,279,603	301.2	14,114,629.10	Konf. ZVRPP
67	Isa	Sherif	Dautaj	3866	315/609/3	Arë, Truall Ndërtesë	58	11	448	4928	47	4242	199,374	130.8	53500	6997800	47	1,214,296	177.8	8,416,398.03	Konf. ZVRPP
68	Isa	Sherif	Dautaj	3866	315/609/4	Truall Ndërtesë	52				28	4242	118,776	83.4	53500	4461900	40	1,033,434	123.4	5,614,109.50	Konf. ZVRPP
69	Nimet	Zeqir	Saraçi	3866	305/320	Are+ Truall	400	81.7	448	36601.6	147	4242	623,574							660,175.60	Konf. ZVRPP
70	Albert Hyqmet Ilir Sokol	Hajredin Hamdi Hamdi	Valteri Valteri Çupi Çupi	3866	305/321	Truall Ndërtesë	310.1				305	4242	1,293,810	260.2	53500	13920700	370.8	10,610,224.18	631	25,824,734.18	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të ProCredit Bank
71	Albert Hyqmet Ilir Sokol	Hajredin Hamdi Hamdi	Valteri Valteri Çupi Çupi	3866	305/322	Truall Ndërtesë	528							886	53500	47401000	1190.6	34,068,320	2076.6	81,469,319.60	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të ProCredit Bank
72	Fiqirete	Muharrem	Shima	2679	440/278	Truall, Ndertese	205				103	4242	436,926	227.6	53500	12176600			227.6	12,613,526.00	Konf. ZVRPP
73	Emin	Ram	Dokushi	2679	440/201	Truall, Ndertese	761				761	4242	3,228,162				154	52,379,709	154	55,607,871.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Banka Amerkane e Investimeve,
74	Latif	Ramiz	Perkola	2679	440/416	Truall, Ndertese	481				120	4242	509,040				62.6	1,799,271	62.6	2,308,311.00	Konf. ZVRPP
75	Refki	Rasim	Peposhi	2679	440/53	Truall, Ndertese	1730				1248	4242	5,294,016				465	6,807,388	465	12,101,404.42	Konf. ZVRPP
76	Fadil	Alush	Duraku	3866	315/575	Truall	4000				543	4242	2,303,406							2,303,406.00	Konf. ZVRPP, Kufizime ne seksionin E te karteles
77	Fadil	Alush	Duraku	3866	315/576	Truall, Ndertese	1000				388	4242	1,645,896					4,310,173		5,956,069.14	Konf. ZVRPP, Kufizime ne seksionin E te karteles
78	Edmond	Seit	Mema	3866	315/173-ND 315/173	Ndertese Are	500	360	448	161280							316.4	7,607,337	316.4	7,768,617.00	Konf. ZVRPP, Kufizime ne seksionin E



																			0	te karteles	
79	Kostandin	Thanas	Theodhori	3866	315/176	Are	180	180	448	80640									80,640.00	Konf. ZVRPP	
80	Haxhi	Zenel	Lilaj	3866	315/80	Are, Truall Ndërtesë	200	37	448	16576	163	4242	691,446	242.3	53500	12963050		242.3	13,671,072.00	Konf. ZVRPP	
81	Haxhi	Zenel	Lilaj	3866	315/590	Are	86	86	448	38528									38,528.00	Konf. ZVRPP	
82	Nazif	Ramadan	Lekli	3866	315/592	Are	104.3	104.3	448	46726.4									46,726.40	Konf. ZVRPP	
83	Nazif	Ramadan	Lekli	3866	315/593	Truall, Ndertese	376.7				376.7	4242	1,597,961	217.2	53500	11620200		217.2	13,218,161.40	Konf. ZVRPP	
84	Rajmonda	Myftar	Hoxhallari, (Shegaj)	3866	306/210	Truall Are Ndërtesë	500	109.5	448	49056	214.5	4242	909,909	286.2	53500	15311700	127.5	3,464,785	19,735,450.00	Konf. ZVRPP	
85	Feim		Llana	3866	315/537	Truall, Ndertese	238				203	4242	861,126	429	53500	22951500	252.4	8,849,945	32,662,571.32	Konf. ZVRPP	
86	Bashkim	Ramazan	Drita	3866	315/68	Are Truall Ndërtesë	375	37.4	448	16755.2	337.6	4242	1,432,099	400	53500	21400000	154	4,025,941	26,874,795.51	Konf. ZVRPP,Bllokuar në favor të NBG.	
87	Bashkëpronarët Llagami dhe te tj.			3866	215/200	Are	7352.2	1406	448	629888									629,888.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të shoqërisë "Romano"	
88	Bashkëpronarët Llagami dhe te tj.			3866	305/291	Truall	17860				580	4242	2,460,360						2,460,360.00	Konf. ZVRPP	
89	Mondi	Guri	Goxha	3866	301/220	Are	1700	84	448	37632									37,632.00	Konf. ZVRPP	
90	Skender		Doda	2679	440/298	Truall	500				113	4242	479,346						479,346.00	Konf. ZVRPP, Gjurma e shpronësimit prek edhe njësinë e shërbimit, për të cilën nuk janë hedhur të dhënat në tabelë, pasi grupit të vlerësimit nuk i janë lejuar matjet.	
91	Sabri	Rushit	Gjana	3866	315/580	Are Truall Ndërtesë	244	27.4	448	12275.2	216.6	4242	918,817	146.9	53500	7859150	131	4,169,745	12,959,987.10	Konf. ZVRPP	
92	Hedli	Syri	Alcani	3866	315/645	Are	300	58	448	25984									25,984.00	Konf. ZVRPP	
93	Qemal	Xhevdet	Lazimi	2679	440/98	Are	100	100	448	44800									44,800.00	Konf. ZVRPP	
94	Bashkëpronarët		Kasi	2679	440/68	Are	2000	1220	448	546560									546,560.00	Konf. ZVRPP	
		Boçi																			
95	Drini	Ramazan	Kryemadhi	2679	440/97	Are	400	400	448	179200									179,200.00	Konf. ZVRPP	
96	Bashkëpronarë Boçi dhe te tj.			2679	440/106	Are	2800	1228	448	550144									550,144.00	Konf. ZVRPP	
97	Arben	Lush	Qokaj	2679	440/338	Truall Ndërtesë	190.1				101	4242	428,442				333.4	11,253,139	333.4	11,681,580.99	Konf. ZVRPP
98	Bashkëpronarët		Brahimaj dhe Lleshi	3866	305/292	Truall	299.9				42	4242	178,164						178,164.00	Konf. ZVRPP	
99	Ali	Xhemal	Dima	3866	306/364	Are	23.9	13	448	5824									5,824.00	Konf. ZVRPP, Kufizime ne favor te Raiffeissen Bank	
100	Ali		Dima	3866	306/365	Truall, Ndertese	356.1				137	4242	581,154	739.2	53500	39547200		739.2	40,128,354.00	Konf. ZVRPP, Kufizime ne favor te Raiffeissen Bank	
101	Adem	Sadri	Doçi	8210	7/335-ND	Ndërtesë	65						65	65000	4225000			65	4,225,000.00	Konf. ZVRPP	
102	Ideal, Jetmir	Shefqet	Billa	8210	7/514-ND	Ndërtesë	105.2						130	65000	8450000	105.2	2,787,884	235.2	11,237,883.91	Konf. ZVRPP	
103	Nazif	Ram	Miha	8210	7/296-ND	Ndërtesë	205.7									418.4	8,758,638	418.4	8,758,638.00	Konf. ZVRPP	
104	Sokol	Bafiti	Qokaj	8210	7/467-ND	Ndërtesë	122.8						366	65000	23790000	146.2	4,074,230	512.2	27,864,230.	Konf. ZVRPP	



																			00	
105	Gëzim	Muhareem	Lluka	8310	12/283-ND	Ndërtesë	57.7						57.7	70000	4039000			57.7	4,039,000.00	Konf. ZVRPP
106	Lutfi	Adem	Pira	8310	12/10-ND	Ndërtesë	86.4						86.4	70000	6048000			86.4	6,048,000.00	Konf. ZVRPP, Kufizime ne seksionin "E" te karteles
107	Shpend		Ndreu	8310	12/122-ND	Ndërtesë	45.6						45.6	70000	3192000			45.6	3,192,000.00	Konf. ZVRPP
108	Altin		Ndreu	8310	12/123-ND	Ndërtesë	20						20	70000	1400000			20	1,400,000.00	Konf. ZVRPP,
109	Gjergji	Lluka	Sholla	8310	12/130-ND	Ndërtesë	59.7						59.7	70000	4179000			59.7	4,179,000.00	Konf. ZVRPP
110	Bujar	Arshin	Sadikllari	8310	12/280-ND	Ndërtesë	60.5						60.5	70000	4235000			60.5	4,235,000.00	Konf. ZVRPP
111	Viktor	Zef	Drobaj	3866	315/45-ND1	Ndërtesë	234						164	53500	8774000	350	7,578,837	514	16,352,837.00	Konf. ZVRPP
112	Shukri	Sabri	Gjana	3866	315/615	Are Truall Ndërtesë	420	104.1	448	46636.8	283.9	4242	1,204,304	53500	18832000			352	20,082,940.60	Konf. ZVRPP
113	Angjelin	Nikoll	Gjergji	3866	315/608-ND	Ndërtesë										248.6	6,621,401	248.6	6,621,401.00	Konf. ZVRPP
114	Paolo	Fiqiri	Buci	3866	315/539-ND	Ndërtesë														Konf. ZVRPP, Ka kufizime ne seksionin "E" te karteles
115	Kujtim	Medat	Osmani	3866	315/539-ND	Ndërtesë							139.8	53500	7479300	264.6	4,609,630	404.4	12,088,930.00	Konf. ZVRPP, Ka kufizime ne seksionin "E" te karteles
116	Bashkim		Muhametaj	3866	315/551	Truall, Ndertese	130				38	4242	161,196	53500	5697750	94.5	2,580,462	201	8,439,408.00	Konf. ZVRPP
117	Ismail	Xhetan	Nesimi	2679	440/337	Truall	326.2				241	4242	1,022,322						1,022,322.00	Konf. ZVRPP, kufizime ne favor te BSGA, Gjurma e shpronesimit prek edhe njesine e sherbimit, per te cilen nuk jane hedhur te dhenat ne table, pasi grupit te vleresimit nuk i jane lejuar matjet.
118	Leonard	Ali	Muja	8210	7/6-ND	Ndërtesë							88.5	65000	5752500	41.8			5,752,500.00	Konf. ZVRPP, Gjurma e shpronesimit prek objektin, per te cilen nuk jane hedhur te dhenat ne table, pasi grupit te vleresimit nuk i jane lejuar matjet.
119	Xhavit	Bejtulla	Dajti	3866	306/150	Are	1400	470	448	210560									210,560.00	Konf. ZVRPP, Ka kufizime ne seksionin "E" te karteles
120	Arjan Mariglen	Halil Hasan	Dedja Dedja	3866	315/223	Are	1746	1577	448	706496									706,496.00	Konf. ZVRPP
121	Selm	Arshi	Ahmeti	3866	315/125	Are	250	121	448	54208									54,208.00	Konf. ZVRPP
122	Mynyr	Arshi	Ahmeti	3866	315/226	Are	524	372	448	166656									166,656.00	Konf. ZVRPP, Ka kufizime ne seksionin "E" te karteles
123	Naimir	Luan	Kurti	8310	12/141	Truall	130				130	31219	4,058,470						4,058,470.00	Konf. ZVRPP
124	Adrian Alb Star Anton Arben Besim Besnik Euro shpk Muhamet Roland		Doçi shpk Gjinaj Resuli Elshani Istrefi Alba Ae Bitri Manushi	8310	12/117	Truall	5488				73	31219	2278987						2,278,987.00	Konf. ZVRPP, Sekuestro Konservative dhe kufizime ne seksionin E te karteles



125	Sali	Lutfi	Avdillari	3866	305/60	Are	80	80	448	35840										35,840.00	Konf. ZVRPP	
126	Bashkim		Kraja	2679	440/431	Truall, Ndertese	210				210	4242	890820	64.26	53500	3437910	51	1,365,491.29	115.26	5,694,221.29	Konf. ZVRPP	
127	Bashkim		Kraja	2679	440/430	Truall, Ndertese	96				42	4242	178164	75.74	53500	4052090	64	1,713,557.71	139.74	5,943,811.71	Konf. ZVRPP	
128	Rasim	Tahir	Kraja	2679	440/433	Truall, Ndertese	75.2				75.2	4242	318998.4	43.7	53500	2337950				2,656,948.40	Konf. ZVRPP	
129	Rasim	Tahir	Kraja	2679	440/432	Truall, Ndertese	217.7				20.8	4242	88233.6	62	53500	3317000				3,405,233.60	Konf. ZVRPP	
130	Lame	Muhamet	Muço	3866	315/656	Truall, Ndertese	30				30	4242	127260				30	785,103.6	30	912,363.60	Konf. ZVRPP	
131	Lame	Muhamet	Muço		315/655	Truall, Ndertese	53.7										53.7	1,405,335.42	53.7	1,405,335.42	Konf. ZVRPP	
132	Lame	Muhamet	Muço		315/654	Truall	22				22	4242	93324							93,324.00	Konf. ZVRPP	
133	Servet Adriatik Arjan	Maze	Merko		315/652	Truall, Ndertese	101				101	4242	428442				32.09	551,390.2	32.09	979,832.20	Konf. ZVRPP	
134	Servet Adriatik Arjan	Maze	Merko		315/651	Ndërtesë	399										78.31	1,345,570.80	78.31	1,345,570.80	Konf. ZVRPP	
135	Astrit	Hekur	Sadikaj		215/243	Truall, Ndertese	123					118	4242	500556	87.7	53500	4691950	76.1	2,122,368.12	163.8	7,314,874.12	Konf. ZVRPP
136	Astrit	Hekur	Sadikaj		215/244	Ndërtesë									50	53500	2675000	50	1,394,463.88	100	4,069,463.88	Konf. ZVRPP
137	Maediana Muhareem	Kadri Musë	Rexha Rexha		215/246	Truall, Ndertese	71.57					71.57	4242	303599.94	71.57	53500	3,828,995	59.09	2,231,067.7	130.66	6,363,662.64	Konf. ZVRPP, Ne favor te B.K.G.SHA.
138	Maediana Muhareem	Kadri Musë	Rexha Rexha	215/245	Truall, Ndertese	138.43					1.43	4242	6066.06	124.93	53500	6683755.00	118.81	4,485,922.3	243.74	11,175,743.36	Konf. ZVRPP, Ne favor te B.K.G.SHA.	
139	Arianit		Myftaraj	3866	306/207	Are	140	140	448	62720										62,720.00	Konf. ZVRPP	
140	Gani	Sabri	Velaj	3866	315/106	Truall, Ndertese	342				342	4242	1,450,764	197.1	53500	10,544,850	175	3,885,994	372.1	15,881,608.00	Konf. ZVRPP	
141	Shpëtim Maliq	Muhareem Mydeir	Rami Ahmetbejasi	3866	315/555	Truall, Ndertese	438				383	4242	1,624,686	297.9	53500	15,937,650	214	5,242,357	511.9	22,804,692.89	Konf. ZVRPP	
142	Sami	Ymer	Çerri	3866	315/77	Are Truall Ndërtesë	420	257.1	448	115180.8	162.9	4242	691,022	206	53500	11,021,000	70	1,964,907	276	13,792,109.60	Konf. ZVRPP	
143	Flamur	Matosh	Dajçi	2679	440/327	Truall	714.8				527	4242	2,235,534							2,235,534.00	Konf. ZVRPP, Gjurma e shpërnimit prej edhe njesine e sherbimit, per te cilen nuk jane hedhur te dhenat ne tebelet, pasi grupit te vleresimit nuk i jane lejuar matjet.	
144	Ramiz	Skender	Uruçi	2679	440/350	Truall Ndërtesë	156				156	4242	661,752				296.9	7,125,752	296.9	7,787,504.00	Konf. ZVRPP	
145	Ramiz	Skender	Uruçi	2679	440/365	Truall	293				46	4242	195,132							195,132.00	Konf. ZVRPP	
146	Nuri	Xhemal	Dema	3866	305/84	Arë	3260	360	448	161280										161,280.00	Konf. ZVRPP	
SHUMA							18129.5			8122016	21708.5		380666155	8685.3		483397450		352,688,809		1,224,874,430.42		

Shënim: 1. Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000

2. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë truall” dhe “tokë arë”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.



VENDIM
Nr. 234, datë 17.4.2019

**PËR PROGRAMIN E INTEGRUAR TË
ZHVILLIMIT “POLI I DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për programin e integruar të zhvillimit “Poli i Drejtësisë”, nëpërmjet të cilit synohet zhvillimi i një zone urbane në funksion të krijimit të një blloku të integruar infrastrukture për akomodimin e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe të institucione të tjera të interesuara, me qëllim mbështetjen e këtyre institucioneve me infrastrukturën e nevojshme dhe bashkëkohore, në mënyrën më të shpejtë të mundshme.

2. Programi i integruar i zhvillimit “Poli i Drejtësisë” do të zhvillohet në pronën me nr. 1/644, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë, duke përfshirë edhe çdo pronë shtetërore kufitare ose që ndodhet pranë kësaj pasurie, përfshirë pronën me nr. 1/645, pasuri e llojit truall, dhe godinën e ngritur në këtë pronë nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

3. Godina e ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë, është pjesë integrale e zhvillimit të programit, me qëllim sigurimin e ambienteve /zyrave të punës dhe të përfaqësimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës.

4. Programi i integruar i zhvillimit “Poli i Drejtësisë” do të shtrihet në 2 faza, gjatë periudhës kohore 2019–2022.

5. Faza e parë e programit do të shtrihet në periudhën kohore 2019-2020. Për zbatimin e fazës së parë të programit, me urdhër të Kryeministrit krijohet grupi ndërinstitucional i punës, i kryesuar nga përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe me anëtarë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Grupi ndërinstitucional i punës, përveç detyrave të tjera të

ngarkuara me urdhrin e Kryeministrit, kryen edhe detyrat e mëposhtme:

5.1 Vlerëson gjendjen juridike të pronësisë së godinës, të ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, gjendjen ligjore të pronësisë së truallit ku është ndërtuar kjo godinë, përcaktimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme. Nëpërmjet metodave alternative të vlerësimit të sendeve të paluajtshme, duke pasur në konsideratë, veçanërisht, vlerën fillestare të investimit, nëpërmjet vlerësuesve profesionistë.

5.2 Pas përcaktimit të vlerës së godinës, sipas parashikimit të mësipërm, grupi ndërinstitucional i punës inicion procedurën e negocimit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kodin Civil.

5.3 Në përfundim të procesit të negocimit, grupi ndërinstitucional i punës përgatit projektkontratën e blerjes, e cila i përcillet për miratim Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

5.4 Grupi ndërinstitucional i punës, gjatë punës së tij, mund të asistohet nga ekspertë teknikë që do të jenë të ngarkuar të bëjnë vlerësimin e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Kontraktimi i ekspertëve teknikë kryhet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

6. Faza e dytë e programit do të shtrihet në periudhën kohore 2020–2022, gjatë së cilës kryhen veprimet e mëposhtme:

6.1 Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, do të hartojë dokumentacionin e domosdoshëm për pajisjen me lejet përkatëse për ndërtimin/zhvillimin e projekteve në pasuritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

6.2 Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të marrë masa që të përcaktojë buxhetin e nevojshëm për financimin e vlerësimit, të projektimit, të zbatimit të punimeve dhe të mirëmbajtjes së godinave pjesë përbërëse të “Polit të Drejtësisë”.

6.3 Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë agjencia zbatuese për projektimin dhe zbatimin e punimeve për ndërtimin e godinave dhe të infrastrukturës mbështetëse të “Polit të Drejtësisë”.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Ministria e Punëve të Brendshme, Detyrë 7/11/1994

KARTELA E PASURISE SE PALUATTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 8210 NR I PASURISE: 1/644

Indeksi Hartes: TR; M-6

Adresa e Pasurisë: Rrethi: TIRANE Q/ë: TIRANE

PERFUNDIMTARE (data): 20/10/2012

Vol. 39 Fq. 107

Vijon nga Vol. 29 Fq. 107

Vijon në Vol. Fq. deri në Vol. Fq.

Emri: BENIAMIN KRUTA P/Gj: SHI K Ap

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALI Brenda V.K.N.: PO Ref. PL.BREG

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale sa Truali	Nga Sip. Truali sa Nderesi
1 7,564.00 m ²	1 7,564.00 m ²	1 m ²
Ref. 00014641	Ref. 00014641	Ref.
2 m ²	2 m ²	2 m ²
Ref.	Ref.	Ref.
3 m ²	3 m ²	3 m ²
Ref.	Ref.	Ref.
4 m ²	4 m ²	4 m ²
Ref.	Ref.	Ref.

Per pjesen e përbashkët: PALLAT

Konta e pjesmarryes %

Nr i Pasurise (pallat):

Vol. Fq.

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr Dok.	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e lësh. Çertifikates	Shënime	Firma
00014641	29/03/2019	SHIET				I	TIRANË		29/03/2019	TNd pasurise	

Num. Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)



D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERIODIN, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok.	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
00000006	10/10/2017	R24	MIRËKËTË PASURITESHË REGISTRUAR QIKËTË KORPUSH AVOKATIA* NE VOR. T PAQE T B. REGJISTRIT TE KARABINASE			
00011896	10/10/2017	R24	NE PERSON QJESHT ADMINISTRIM TE DHEGJES LUMBITARE TE AVOKATISE PER TA PERSORZUA PER NDERHETIM E SHPOSLES KEDHIGJARS TE AVOKATISE		URDHËR V.K. MATO 11/07/2013	

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tiranë

TIRANE, më 16 / 4 / 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
Në regjistrin Vol 39, Faqe 91, Zona Kadastrale 8210, Qyteti Tirre

REGISTRUESI

ELION SEMANAJ



**D - SI KSIONI QIKAVE, NE PERDORIM, MARDHET SI LJEVE KUFIZUESE.
SERVITURAVE DHE INTRESAVE TE TJERA**

Nr Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shtëpime	Firma
00013086	30/10/2017	RFA	Nr. 41 KQJ-GJESI ADMINISTRIMI TE DPOMES KOMBETARE TE AVOKATISE PER TA ZVENDOSUR PER NDEJTIMEN E BUKOLLES KOMBETARE TE AVOKATISE		ULENDE V.K. Nr. 10 DT. 30.10.2017	

F - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Pershkrimi	Data e l.esh. Certifikates	Shenime	Firma

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

Adresa: Kruga Jordan (Mija, Tiranë) TIRANË, me 16 / 4 /20
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
Në regjistrin Vol 39, Faqe 90, Zona Kadastrale 8210, Qyteti Tiranë

REGISTRUESI
ELION SEMANAJ

[illegible]

**URDHËR¹****Nr. 173, datë 12.4.2019****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR RAPORTIMIN DHE NDJEKJEN E
NGJARJEVE NË AVIACIONIN CIVIL NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të shkronjës “ç” të nenit 7 dhe nenit 104 të ligjit 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve / Aksidenteve Ajrore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri i ministrit nr. 68, datë 10.6.2011 “Për miratimin e rregullore për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil” dhe urdhri i ministrit nr. 123, datë 22.12.2011 “Për miratimin e rregullore për integrimin në një bazë qendrore

të informacionit për ngjarjet në aviacionin civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara” shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku

**RREGULLORE
PËR RAPORTIMIN DHE NDJEKJEN E
NGJARJEVE NË AVIACIONIN CIVIL NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË****Neni 1
Objektivat**

1. Kjo rregullore ka për qëllim përmirësimin e sigurisë ajrore (*aviation safety*) duke siguruar që informacioni përkatës në lidhje me aviacionin civil, raportohet, mbledhet, ruhet, mbrohet, shkëmbehet, shpërndahet dhe analizohet.

2. Kjo rregullore ka për qëllim të garantojë:

a) aty ku është e përshtatshme, ndërmarrjen në kohë të veprimeve për sigurinë në operim, bazuar në analizën e informacionit të mbledhur;

b) disponueshmërinë e vazhdueshme të informacionit të sigurisë në operim (*safety*), duke bërë të njohur rregullat e konfidencialitetit dhe të përdorimit të duhur të informacionit, përmes harmonizimit dhe rritjes së mbrojtjes së raportuesve dhe personave të përmendur në raportet e ngjarjeve; dhe

c) që rreziqet e lidhura me sigurinë ajrore të operimeve të konsiderohen dhe të trajtohen në nivel kombëtar.

3. Objektivi i vetëm i raportimit të ngjarjeve është parandalimi i aksidenteve dhe incidenteve dhe jo ngarkimi me faj apo përgjegjësi.

**Neni 2
Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Aksident” është një ngjarje që lidhet me operimin e një avioni, ngjarje që në rastin e avionit me ekuipazh mund të ndodhë midis kohës kur pasagjerët hipin në bord për të

¹ Ky urdhër përaftron rregulloren (BE) nr. 376/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 3 prill 2014, mbi raportimin, analizën dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 996/2010, dhe shfuqizon direktivën 2003/42/KE, dhe rregulloret (KE) nr. 1321/2007 dhe (KE) nr. 1330/2007, Fletore Zyrtare e BE L 122, datë 24.4.2014, e ndryshuar nga rregullorja (BE) 2018/1139 e PE dhe Këshillit e 4 Korrik 2018.



udhëtuar dhe kohës kur ata zbresin, ose në rastin e avionit pa ekuipazh, nga koha kur avioni është gati të lëvizë për qëllime të fluturimit deri në kohën që ai ndalon së lëvizuri dhe pasi motori të jetë fikur. Ngjarja rezulton si aksident kur:

a) një person ka pësuar lëndime fatale apo serioze si pasojë e:

- pranisë në avion;
- kontaktit të drejtpërdrejtë me ndonjë pjesë të avionit, përfshirë këtu edhe pjesë të cilat janë shkëputur nga avioni; ose
- ekspozimit të drejtpërdrejtë të shpërthimit reaktiv të avionit;

Përveç rasteve kur lëndimet janë nga shkaqe natyrore, të vetëshkaktuara apo të shkaktuara nga persona të tjerë, apo kur lëndimet vijnë nga persona të fshehur jashtë zonave të cilat normalisht janë të aksesueshme për pasagjerët dhe ekuipazhin; apo

b) avioni ka avari apo ka mosfunksionim strukturor, të cilat:

- ndikojnë negativisht në rezistencën strukturore, performancën apo karakteristikat e fluturimit të avionit; dhe
- kërkojnë normalisht riparim madhor apo zëvendësim të pjesës së dëmtuar;

- bëjnë përjashtim rastet e dëmtimit apo të mosfunksionimit të motorit, kur ky dëmtim apo mosfunksionim kufizohet te një motor i vetëm (duke përfshirë mburojën metalike të avionit dhe aksesoret e tij), apo kur dëmtimi kufizohet tek helikat, pjesët e krahëve, antenat, sondat, gomat, frenat, panelet, pajisjet e hapjes së dyerve, te xhami i përparmë, në veshjen e avionit (të tilla si goditje apo të çara të vogla) ose kur kufizohet në dëmtime të vogla të helikës kryesore (rotorit), të helikës së bishtit të avionit, të pajisjes së uljes dhe kur këto dëme rezultojnë nga breshëri apo përplasja e zogjve me avionin (duke përfshirë këtu edhe të çarat në pajisjen e radarit); ose

c) avioni humb apo është krejtësisht i paarritshëm.

2. “Anonimati” do të thotë largimi nga raportimi i ngjarjeve i çdo të dhëne personale lidhur me raportuesin dhe personat e përmendur në raportim dhe i çdo hollësie, duke përfshirë emrin e organizatës ose organizatave të përfshira në ngjarje, të cilat mund të zbulojnë identitetin e raportuesit ose të palëve të treta ose që çojnë në informacionin që nxirret nga raportimi i ngjarjes.

3. “Avion” është çdo mjet që përfiton qëndrim në atmosferë nga kundërveprimi i ajrit, përveç kundërveprimit të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës.

4. “ECCAIRS” nënkupton qendrën evropiane të koordinimit për sistemin e raportimit të ngjarjeve.

5. “Incident” nënkupton një ngjarje gjatë operimit të një avioni, e ndryshme nga aksidenti, e cila ndikon ose mund të prekë sigurinë e operimit.

6. “Incident serioz” nënkupton një incident, i cili përfshin rrethana që tregojnë se ka pasur një probabilitet të lartë për një aksident dhe është i lidhur me funksionimin e një avioni, i cili në rastin e një avioni me ekuipazh ndodh ndërmjet kohës që personat kanë hipur në avion me qëllim fluturimi deri në kohën kur të gjithë këta persona kanë zbarkuar, ose në rastin e një avioni pa ekuipazh, ndodh ndërmjet kohës që avioni është gati për të lëvizur me qëllim fluturimi deri në kohën e pushimit në nivelin e fundit të fluturimit dhe kur sistemi primar shtytës është mbyllur.

7. “Informacion i paidentifikuar” nënkupton informacionin e dalë nga raportimi i ngjarjeve, nga i cili çdo e dhënë personale, e tillë si emër ose adresë e personit fizik, është hequr.

8. “Kulturë e drejtë” (*Just culture*) nënkupton një kulturë ku operatorët e vijës së parë ose persona të tjerë nuk dënohen për veprimet, mosveprimet apo vendimet e marra në përputhje me trajnimet dhe përvojën e tyre, por në të cilën nuk tolerohen neglizhenca e madhe, shkeljet me paramendim dhe aktet shkatërruese.

9. “Ngjarje” nënkupton çdo ngjarje të lidhur me sigurinë që rrezikon ose në rast moskorrigjimi mund të rrezikojë një avion, pasagjerët e tij ose çdo person tjetër dhe që përmban në mënyrë të veçantë një aksident ose incident serioz.

10. “OKIIA” nënkupton Organin Kombëtar për Investigimin e Incidenteve dhe Aksidenteve për sigurinë në aviacionin civil, që kryen ose mbikëqyr investigimet për sigurinë, siç përcaktohet në Kodin Ajror të RSH-së.

11. “Organizatë” është çdo organizatë e cila ofron shërbime ose produkte të aviacionit dhe/ose punëson, kontraktin ose përdor shërbimet e personave të nevojshëm për të



raportuar ngjarjet në përputhje me nenin 4, pika 6, të kësaj rregulloreje.

12. “Palë e interesuar” nënkupton çdo person fizik ose juridik apo çdo organ zyrtar, që ka ose jo personalitetin juridik, që është në gjendje të marrë pjesë në përmirësimin e sigurisë ajrore duke pasur akses në informacionin e shkëmbyer mbi ngjarjet e përcaktuara në aneksin II, pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

13. “Pikë kontakti” do të thotë:

a) Për Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Aviacionit Civil ose OKIIA, i përcaktuar nga Ministri në përputhje me nenin 6, pika 3, kur një kërkesë për informacion është bërë nga një palë e interesuar e vendosur në Republikën e Shqipërisë, për një informacion të ndodhur në bazën kombëtare të të dhënave;

b) Komisioni, kur një kërkesë për informacion nga Baza Evropiane e të Dhënave është bërë nga një palë e vendosur jashtë Bashkimit Evropian;

14. “Plani Evropian i Sigurisë Ajrore” nënkupton vlerësimin e çështjeve të sigurisë dhe planin përkatës të veprimit në nivel evropian.

15. “Programi Shtetëror i Sigurisë” nënkupton një grup të integruar aktesh ligjore dhe aktiviteteve që kanë për qëllim menaxhimin e sigurisë në aviacionin civil.

16. “Programi Evropian i Sigurisë Ajrore” nënkupton tërësinë e integruar të rregulloreve në nivel Bashkimi Evropian së bashku me aktivitetet dhe proceset e përdorura për të menaxhuar bashkërisht sigurinë e aviacionit civil në nivelin evropian.

17. “Rrezik” nënkupton një situatë ose një objekt me potencialin për të shkaktuar vdekje ose lëndim të një personi, dëmtim të pajisjeve ose një strukturë, humbje të materialit, ose reduktim të aftësive për të performuar një funksion të caktuar.

18. “Raportues” është një person i cili raporton një ngjarje ose informacion tjetër lidhur me sigurinë në operim në përputhje me këtë rregullore.

19. “Sistem i menaxhimit të sigurisë” nënkupton një qasje sistematike për menaxhimin e sigurisë ajrore duke përfshirë strukturat e nevojshme organizative, përgjegjshmërinë, politikat dhe procedurat, dhe përfshin çdo sistem të menaxhimit që në mënyrë të pavarur ose të

integruar me sisteme të tjera të menaxhimit të organizatës adreson menaxhimin e sigurisë.

Neni 3

Subjekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat për:

a) raportimin e ngjarjeve të cilat rrezikojnë, ose në rast se nuk adresohen apo korrigjohen do të rrezikojnë një avion, pasagjerët e tij, ose çdo person tjetër, pajisjet ose instalimet, të cilat ndikojnë në operimet e avionit; dhe raportimin e informacioneve të tjera të lidhura me sigurinë në operim;

b) analizat dhe veprimet në vijim në lidhje me ngjarjet e raportuara dhe informacionet e tjera, të lidhura me sigurinë;

c) mbrojtjen e profesionistëve të aviacionit;

d) përdorimin e duhur të informacionit të mbledhur;

e) integrimin e informacionit në programin ECCAIRS;

f) shpërndarjen e informacionit anonim, palëve të interesuara, me qëllim sigurimin e këtyre palëve, të informacionit që u nevojitet, për përmirësimin e sigurisë ajrore;

2. Kjo rregullore aplikohet për ngjarjet dhe informacione të tjera lidhur me sigurinë në operim, që përfshijnë avionët civilë, me përjashtim të avionëve të përmendur në aneksin II të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”.

Neni 4

Raportimi i detyrueshëm

1. Ngjarjet të cilat përfaqësojnë një rrezik domethënës për sigurinë në operim dhe të cilat bien në kategoritë e mëposhtme duhet të raportohen nga personat e listuar në pikën 4 përmes sistemit të raportimit të detyrueshëm sipas këtij neni:

a) ngjarje të lidhura me operimin e avionit, të tilla si:

i) ngjarje të lidhura me përplasjet;

ii) ngjarje të lidhura me ulje-ngritjet;

iii) ngjarje të lidhura me karburantin;

iv) ngjarje gjatë fluturimit;

v) ngjarje të lidhura me komunikimin;



vi) ngjarje të lidhura me dëmtime, emergjenca dhe situata të tjera kritike;

vii) ngjarje të lidhura me paaftësinë e ekuipazhit dhe të tjera të lidhura me ekuipazhin;

viii) ngjarje të lidhura me kushtet meteorologjike dhe sigurinë;

b) ngjarje të lidhura me kushtet teknike, mirëmbajtjen dhe riparimin e avionit, të tilla si:

i) defekte strukturore;

ii) mosfunksionime të sistemit;

iii) probleme të mirëmbajtjes dhe riparimit;

iv) probleme të lëvizjes (përfshirë motorin, helikat dhe sistemet e rotorit) dhe probleme të njësive ndihmëse të energjisë;

c) ngjarje të lidhura me shërbimet e lundrimit ajror dhe objekteve, të tilla si:

i) përplasjet, thuajse përplasjet ose përplasjet e mundshme;

ii) ngjarje specifike të menaxhimit të trafikut ajror dhe shërbimeve të lundrimit ajror;

iii) ngjarje operationale ATM/ANS;

d) ngjarje të lidhura me aerodromet dhe shërbimet tokësore të tilla si:

i) ngjarje të lidhura me aktivitetet dhe objektet në aerodrom;

ii) ngjarje të lidhura me trajtimin e udhëtarëve, bagazheve, postës dhe mallrave;

iii) ngjarje të lidhura me trajtimin e avionëve në tokë dhe shërbimeve të lidhura me to;

2. Çdo organizatë që operon në fushën e aviacionit civil duhet të krijojë një sistem të detyrueshëm raportimi për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave mbi ngjarjet përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të krijojë një sistem të detyrueshëm raportimi për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave mbi ngjarjet duke përfshirë mbledhjen e të dhënave të mbledhura nga organizatat në përputhje me pikën 2.

4. Personat e mëposhtëm fizikë duhet të bëjnë raportimin e ngjarjeve të përmendura në pikën 1, përmes sistemit të vendosur në përputhje me pikën 2, nga organizata e cila punëson, kontraktun apo përdor shërbimet e raportuesit ose në mungesë, në përputhje me pikën 3 përmes sistemit të vendosur nga Autoriteti i Aviacionit Civil:

a) piloti në komandë, ose në rastet kur piloti në komandë nuk është në gjendje të raportojë

ngjarjen, çdo anëtar tjetër i ekuipazhit në zinxhirin komandues të një avioni të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, për të cilin Autoriteti i Aviacionit Civil siguron mbikëqyrjen e operimeve; ose të një avioni të regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë, por i përdorur nga një operator i themeluar në Republikën e Shqipërisë, ose nga një operator i themeluar në Bashkimin Evropian, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;

b) një person i angazhuar në projektimin, prodhimin, monitorimin e vazhdueshëm të vlefshmërisë ajrore, mirëmbajtjen ose modifikimin e një avioni ose ndonjë pajisjeje dhe pjesëve të tyre, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Aviacionit Civil;

c) një person i cili nënshkruan rishikimin e certifikatës së vlefshmërisë, apo një lirim për shërbim, në lidhje me një avion ose të çdo pajisjeje dhe pjesëve të tyre, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Aviacionit Civil;

d) një person i cili kryen një funksion që i kërkon atij ose asaj të jetë i autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil si anëtar i stafit, i ofruesit të shërbimit të trafikut ajror i ngarkuar me përgjegjësitë që lidhen me shërbimet e lundrimit ajror ose si një oficer shërbimi i informacionit të fluturimeve;

e) një person i cili kryen një funksion që lidhet me menaxhimin e sigurisë së operimit të një aeroporti, për të cilin zbatohet udhëzimi i ministrit nr. 17, datë 2.9.2010 “Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore”, i ndryshuar;

f) një person i cili kryen një funksion që lidhet me instalimin, modifikimin, mirëmbajtjen, riparimin, rregullimin, kontrollin e fluturimeve ose inspektimin e pajisjeve të lundrimit ajror për të cilat Autoriteti i Aviacionit Civil është mbikëqyrës;

g) një person i cili kryen një funksion që lidhet me trajtimin e avionëve në tokë, përfshirë furnizimin me karburant, përgatitjen e dokumentit të ngarkesës, ngarkesën, shkrirjen e akullit dhe rimorkimin në aeroport për të cilin zbatohet udhëzimi i ministrit nr. 17, datë 2.9.2010 “Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore, i ndryshuar.

5. Personat e listuar në pikën 4 duhet t'i raportojnë ngjarjet brenda 72 orësh pasi janë



vënë në dijeni për ngjarjen, përveç rasteve kur ka rrethana të veçanta që e pengojnë këtë.

6. Në vijim të njoftimit të një ngjarjeje, çdo organizatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë, e cila nuk mbulohet në pikën 7, duhet t'i raportojë AAC, siç përmendet në nenin 6(3), të dhënat mbi ngjarjet e mbledhura në përputhje me pikën 2 të këtij neni sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast jo më vonë se 72 orë pasi janë vënë në dijeni për ngjarjen.

7. Në vijim të njoftimit të një ngjarjeje, çdo organizatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë, e cila është e certifikuar apo miratuar nga Agjencia sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, apo Marrëveshjes së Punës me Agjencinë, duhet t'i raportojë asaj të dhënat mbi ngjarjet e mbledhura në përputhje me pikën 2 sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast jo më vonë se 72 orë pasi janë vënë në dijeni për ngjarjen.

Neni 5

Raportimi vullnetar

1. Organizatat e certifikuara/licencuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të ngrenë një sistem raportimi vullnetar për të lehtësuar mbledhjen e:

a) të dhënave mbi ngjarjet të cilat nuk mund të kapen nga sistemi i detyrueshëm i raportimit;

b) informacione të tjera të lidhura me sigurinë në operim, të cilat perceptohen nga raportuesi si një rrezik potencial për sigurinë në operim. Ky sistem duhet gjithashtu të përfshijë, por pa u kufizuar, mbledhjen e informacionit të transferuar nga organizatat në përputhje me pikën 6.

2. Sistemi i raportimit vullnetar duhet të përdoret për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave mbi ngjarjet dhe informacionet e tjera të lidhura me sigurinë:

a) që nuk janë subjekt i raportimit të detyrueshëm në përputhje me nenin 4, pika 1;

b) të raportuara nga persona të cilët nuk janë të listuar në nenin 4, pika 4;

3. Organizatat e certifikuara/licencuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në kohën e duhur, duhet t'i raportojnë AAC-së të dhëna mbi ngjarjet dhe informacione të tjera lidhur me sigurinë, të cilat janë mbledhur në përputhje me

pikën 1 dhe të cilat mund të përbëjnë një rrezik potencial të mundshëm për sigurinë në operim.

4. Çdo organizatë e cila nuk është e certifikuar apo miratuar nga AAC-ja, duhet që në kohën e duhur t'i raportojë AAC-së, siç përcaktohet në përputhje me nenin 6, pika 3, të dhëna mbi ngjarjet dhe informacione të tjera të lidhura me sigurinë, të mbledhura në përputhje me pikën 1 të këtij neni, të cilat mund të përfshijnë në një rrezik potencial të mundshëm sigurinë në operim. AAC-ja mund t'i kërkojë çdo organizatë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë që të raportojë të dhënat e të gjitha ngjarjeve të mbledhura në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

5. AAC-ja dhe organizatat mund të vendosin sisteme të tjera të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit për të mbledhur të dhëna nga ngjarje të cilat nuk mund të jenë kapur nga sistemet e raportimit të referuara në nenin 4 dhe në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni. Këto sisteme mund të përfshijnë raportimin ndaj subjekteve të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 6 pika 3 dhe mund të përfshijnë pjesëmarrjen aktive:

a) të industrisë së aviacionit;

b) të organizatave profesionale të stafit të aviacionit.

6. Informacioni i marrë nga raportimi vullnetar dhe i detyrueshëm mund të integrohet në një sistem të vetëm.

Neni 6

Mbledhja dhe ruajtja e informacionit

1. Çdo organizatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë duhet të caktojë një ose më shumë persona që do të trajtojnë në mënyrë të pavarur mbledhjen, vlerësimin, përpunimin, analizimin dhe ruajtjen e të dhënave të ngjarjeve të raportuara në përputhje me nenet 4 dhe 5. Trajtimi i raportimeve duhet të bëhet me synimin për të parandaluar përdorimin e informacionit për qëllime të tjera veç atij të sigurisë, dhe duhet mbrojtur në mënyrën e duhur konfidencialiteti i identitetit të raportuesit dhe personave të përmendur në raportimet e ngjarjeve, duke promovuar një "Kulture të drejtë" (*just culture*).

2. Organizatat e vogla, në marrëveshje me Autoritetin e Aviacionit Civil, mund të krijojnë



një mekanizëm të thjeshtuar për mbledhjen, vlerësimin, përpunimin, analizimin dhe ruajtjen e të dhënave të ngjarjeve. Ata mund të ndajnë punën me organizatat e së njëjtës natyrë, duke qenë në përputhje me rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes, në zbatim të kësaj rregulloreje.

3. Trajtimi i raportimeve duhet të bëhet me qëllim parandalimin e përdorimit të informacionit për qëllime të tjera, veç sigurisë dhe duhet të mbrojtë në mënyrë të duhur privatësinë e të dhënave të raportuesit ose të personave të përmendur në raportim, duke promovuar në këtë mënyrë “Kulturën e drejtë” (*just culture*). Autoritetet kompetente, për të krijuar një mekanizëm për të mbledhur, vlerësuar, përpunuar, analizuar dhe ruajtur të dhënat për ngjarjet e raportuara në mënyrë të pavarur, në përputhje me nenet 4 dhe 5 së bashku ose veçmas mund të jenë si më poshtë:

a) Autoriteti Aviacionit Civil; dhe/ose

b) Organi Kombëtar për Investigimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil;

4. Organizatat do të ruajnë raportimet e ngjarjeve, të hartuara në bazë të të dhënave të mbledhura mbi ngjarjet në përputhje me nenet 4 dhe në një apo më shumë baza të dhënash.

5. Autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 3 do të ruajnë raportimet e ngjarjeve të hartuara në bazë të të dhënave të mbledhura mbi ngjarjet, në përputhje me nenet 4 dhe 5 në një bazë qendrore të dhënash.

6. Informacioni lidhur me aksidentet dhe incidentet serioze, i mbledhur ose i nxjerrë nga autoritetet e investigimit, do të ruhet gjithashtu në bazën qendrore të të dhënave.

7. Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve dhe Aksidenteve Ajrore në Aviacionin Civil, do të ketë akses të plotë në bazën përkatëse qendrore siç është përmendur në paragrafin 6, me qëllim që të përmbushin përgjegjësitë e tyre në përputhje me nenin 5(4) të rregullores “Mbi investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil”;

8. Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë akses të plotë në bazat qendrore përkatëse të përmendura në paragrafin 6 për qëllimet e përgjegjësisë që ata kanë lidhur me sigurinë në operim.

Faqe | 4464

Neni 7

Cilësia dhe përmbajtja e raportimit të ngjarjeve

1. Raportimet e ngjarjeve të përmendura në nenin 6 do të përmbajnë të paktën informacionin e listuar në aneksin I.

2. Raportimet e ngjarjeve të përmendura në pikat 5 dhe 6 të nenit 6 do të përfshijnë një klasifikim të rrezikut për ngjarjet përkatëse. Ky klasifikim do të rishikohet ose ndryshohet në rast se do të jetë e nevojshme dhe do të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

3. Organizatat do të krijojnë proceset e kontrollit të cilësisë së të dhënave për të përmirësuar qëndrueshmërinë e të dhënave, sidomos midis informacionit të mbledhur fillimisht dhe atij të ruajtur në data bazë.

Neni 8

Baza e të dhënave

1. Autoritetet kompetente do të menaxhojnë bazën e të dhënave kombëtare, për të ruajtur ngjarjet e raportuara e të mbledhura në aviacionin civil.

2. Autoritetet kompetente duhet të bien dakord me Komisionin për përdorimin dhe përditësimin e programit ECCAIRS.

Neni 9

Shkëmbimi i Informacionit

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë pjesë në një shkëmbim informacioni duke vënë në dispozicion të gjithë informacionin e ruajtur në bazën e tij të të dhënave, duke vënë në dispozicion të autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Agjencisë dhe Komisionit Evropian, nëpërmjet bazës së të dhënave evropiane, të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me sigurinë, duke konsideruar detyrimet e marrëveshjes shumëpalëshe dhe Marrëveshjen e Punës në fuqi me Agjencinë.

Ngjarjet e raportuara duhet të përditësohen sa herë që është e nevojshme, me informacione shtesë lidhur me sigurinë, në programin ECCAIRS.



2. Gjithashtu, nëse kërkohet në bazë të një Marrëveshjeje Pune me Agjencinë, apo një detyrimi bazuar në Marrëveshjen Shumëpalëshe, AAC do të transferojë informacionin lidhur me aksidentet dhe incidentet serioze në bazën e të dhënave evropiane, si më poshtë:

a) gjatë kryerjes së investigimit: informacionin paraprak mbi aksidentet dhe incidentet serioze;

b) kur investigimi ka përfunduar:

i) raportin përfundimtar të investigimit;

ii) kur është e mundur, një përmbledhje në anglisht të raportit përfundimtar të investigimit;

3. Autoriteti i Aviacionit Civil do të komunikojë sa më shpejt të gjithë informacionin përkatës të lidhur me sigurinë në operim, tek shteti përkatës i ZPEA-se ose Agjencia, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, nëse ndërsa mbledh të dhëna të ngjarjeve, ose ndërsa ruan raporte të ngjarjeve, ose ndërsa kryen një analizë në përputhje me nenin 13, pika 6, ai identifikon çështje të sigurisë në operim, të cilat i konsideron si:

a) çështje që janë në interes të shtetit tjetër të ZPEA-se ose agjencisë; ose

b) çështje që mund të kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve në drejtim të sigurisë në operim, nga ana e shtetit tjetër të ZPEA-së ose agjencisë.

Neni 10

Përhapja e informacionit të ruajtur në bazën e të dhënave

1. Autoriteti i Aviacionit Civil, ose Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve, duhet të marrë masa për të pasur akses ose të drejtë për t'u njohur me të gjithë informacionin mbi ngjarjet, që përmban baza e të dhënave evropiane, për aq sa e lejon marrëveshja shumëpalëshe.

Informacioni duhet të përdoret në përputhje me nenin 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje.

2. Palët e interesuara, të listuar në aneksin II të kësaj rregulloreje mund të kërkojnë akses për një informacion të caktuar që përmban baza e të dhënave kombëtare.

3. Palët e interesuara, të themeluara brenda ZPEA-së, duhet t'ua adresojnë kërkesat për informacion pikave të kontaktit të atij shteti ku ata janë vendosur.

4. Palët e interesuara, të themeluara jashtë ZPEA-së, duhet t'ia adresojnë kërkesën e tyre Komisionit Evropian.

5. Në bazë të nenit 15(2) të rregullores “Për investigimit dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në Aviacionin Civil”, informacioni që përmban baza e të dhënave evropiane, në lidhje me investigimin e vazhdueshëm të sigurisë ajrore të kryer në përputhje me këtë rregullore, nuk do t'u bëhet i ditur palëve të interesuar, në përputhje me këtë nen.

6. Për arsye sigurie, palëve të interesuara nuk mund t'u ofrohet akses direkt në bazën e të dhënave kombëtare.

Neni 11

Përpunimi i kërkesave dhe vendimet

1. Kur është e zbatueshme, duke konsideruar parashikimet e marrëveshjes shumëpalëshe, si dhe Marrëveshjen e Punës me Agjencinë, kërkesat për ndonjë informacion që e përmban Baza Qendrore Evropiane do të dorëzohen duke përdorur formularët e miratuar nga pika e kontaktit. Këta formularë duhet të përmbajnë të paktën pikat e përcaktuara në aneksin III.

2. Kur pika e kontaktit përcakton se kërkesa e adresuar atij është kompetencë e Komisionit ose një shteti anëtar të BE-së, ai mund të vendosë ta kalojë kërkesën te Komisioni ose te shteti përkatës anëtar, sipas rastit.

3. Kërkesat për ndonjë informacion të ndodhur në bazën kombëtare të të dhënave do të dorëzohen duke përdorur formën e miratuar nga AAC-ja si pikë kontakti. Forma do të përmbajë pikat e përcaktuara në aneksin III.

4. Pika e kontaktit që merr një kërkesë duhet të kontrollojë nëse:

a) kërkesa është bërë nga pala e interesuar;

b) është kompetencë e tij të merret me këtë kërkesë.

Kur pika e kontaktit konstaton se kërkesa e adresuar atij është një kërkesë jashtë fushës së kompetencave të tij, atëherë palës së interesuar i sugjerohet të kontaktojë pikën e kontaktit kompetent.

5. Pika e kontaktit që merr një kërkesë duhet ta vlerësojë atë rast pas rasti, për të parë nëse kërkesa është e justifikuar dhe e argumentuar.



6. Pika e kontaktit mund t'u japë informacion palëve të interesuara në formë të shkruar ose duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit.

7. Nëse kërkesa pranohet, pika e kontaktit duhet të përcaktojë sasinë dhe nivelin e informacionit që duhet të japë. Informacioni do të kufizohet vetëm në atë që pikërisht kërkohet për qëllimet e kërkuesit, pa rënë ndesh me nenin 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje.

8. Informacioni që nuk lidhet me pajisjet, operimet dhe fushën e aktivitetit të kërkuesit, jepet vetëm në formë të papërpunuar, përveç rastit kur kërkuesi paraqet një justifikim të detajuar. Ky informacion duhet të përdoret në përputhje me nenin 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje.

9. Palët e interesuara të listuara në aneksin II (b) të kësaj rregulloreje, mund të pajisen nga pika e kontaktit vetëm me informacionin që lidhet me pajisjet, operimet apo fushën e aktivitetit të palës së interesuar.

10. Pika e kontaktit që merr një kërkesë sipas listës në aneksin II (a) të kësaj rregulloreje, mund të marrë një vendim të përgjithshëm për t'i dhënë informacion rregullisht asaj pale të interesuar, me kusht që:

a) informacioni i kërkuar të ketë të bëjë me pajisjet, operimet dhe fushën e aktivitetit të vetë palës së interesuar;

b) vendimi i përgjithshëm nuk ofron akses në të gjithë përmbajtjen e bazës së të dhënave;

c) vendimi i përgjithshëm lidhet vetëm me informacionin anonim.

11. Palët e interesuara duhet ta përdorin informacionin e marrë në bazë të këtij neni, duke u bazuar në kushtet e mëposhtme:

a) Palët e interesuara duhet ta përdorin informacionin e marrë vetëm për qëllimin e specifikuar në formën e kërkesës, që duhet të jetë në përputhje me objektivat e parashtruara nenin 1 të kësaj rregulloreje; dhe

b) Palët e interesuara nuk duhet ta zbulojnë informacionin e marrë pa lejen me shkrim nga dhënësi i këtij informacioni dhe gjithashtu duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e duhur për informacionin e marrë.

12. Vendimi për të shpërndarë informacionin sipas këtij neni, kufizohet rigorozisht në atë që kërkohet nga përdoruesi.

Neni 12

Regjistrimi i kërkesave dhe shkëmbimi i informacionit

1. Pika e kontaktit duhet të regjistrojë çdo kërkesë që i vjen dhe veprimet që ka kryer për të.

2. Lista e përditësuar e kërkesave që vijnë dhe veprimet përkatëse të kryera do t'u vihen në dispozicion pikave të kontaktit të vendeve të tjera, të interesuara.

Neni 13

Analiza e ngjarjeve dhe ndjekja në nivel kombëtar

1. Çdo organizatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë do të zhvillojë një proces për të analizuar ngjarjet e mbledhura në përputhje me nenin 4 pika 2 dhe nenin 5 pika 1, të kësaj rregulloreje, me qëllim që të identifikojë rreziqet e sigurisë në operim, të lidhura me ngjarje apo grup ngjarjesh të identifikuara.

Bazuar në këtë analizë, organizatat do të ndërmarrin masa korrigjuese ose parandaluese, të nevojshme për përmirësimi e sigurisë në operimet në aviacion.

2. Gjatë ndjekjes së një analize, siç tregohet në pikën 1 të këtij neni, për të ndërmarrë masat korrigjuese ose parandaluese, të nevojshme për trajtimin e mangësive aktuale apo potenciale të sigurisë në operim të aviacionit, çdo organizatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë, duhet që:

a) të zbatojë veprimin në kohën e duhur; dhe

b) të krijojë një proces për të monitoruar zbatimin dhe efektivitetin e veprimeve të ndërmarra.

3. Çdo organizatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë duhet t'i ofrojë rregullisht, punonjësve të tij dhe personelit të kontraktuar, informacion në lidhje me analizën dhe ndjekjen e ngjarjeve, për të cilat janë ndërmarrë masat parandaluese ose korrigjuese.

4. Kur një organizatë e themeluar në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është subjekt i pikës 5 të këtij neni, identifikon një risk aktual



apo potencial të sigurisë në aviacion, duhet që brenda 30 ditëve nga data e raportimit të ngjarjes nga raportuesi organizata t'i transmetojë Autoritetit të Aviacionit Civil:

a) rezultatet paraprake të analizës së kryer në përputhje me pikën 1, nëse ka; dhe

b) çdo masë që duhet të merret në përputhje me pikën 2.

Organizatave të certifikuar ose të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet t'i transmetojnë këtij autoriteti rezultatet përfundimtarë të analizës, kur kërkohet, sa më shpejt të jetë e mundur. Në parim duhet t'i transmetojnë rezultatet përfundimtare të analizës brenda 3 muajve nga data e raportimit të ngjarjes.

Autoriteti i Aviacionit Civil mund t'i kërkojë organizatave që të transmetojnë pranë tij rezultatet paraprake ose përfundimtare të çdo ngjarjeje, e cila është raportuar, por që në lidhje me të cilën Autoriteti i Aviacionit Civil nuk është informuar për ndjekjen e saj ose ka marrë vetëm rezultatet paraprake.

5. Kur një organizatë e themeluar në RSH është certifikuar dhe miratuar nga Agjencia, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe dhe zbatimit të Marrëveshjes së Punës me Agjencinë, identifikon një risk aktual ose potencial, si rezultat i analizave të tij të ngjarjeve ose të grup-ngjarjeve të raportuara siç parashikohet në nenet 4 dhe 5, duhet t'i raportojë Agjencisë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të ngjarjes nga raportuesi:

a) rezultatet paraprake të analizës së kryer në përputhje me pikën 1, nëse ka; dhe

b) çdo masë që duhet të merret në përputhje me pikën 2.

Organizata e certifikuar ose e miratuar nga Agjencia do të transmetojë tek Agjencia rezultatet përfundimtare të analizave, aty ku kërkohet, sapo ato të jenë në dispozicion dhe, në parim, jo më vonë se 3 muaj nga data e njoftimit të ngjarjes.

Agjencia mund t'i kërkojë organizatave që të transmetojnë pranë tij rezultatet paraprake ose përfundimtare të çdo ngjarjeje, e cila është raportuar, por që në lidhje me të Agjencia nuk është informuar për ndjekjen e saj ose ka marrë vetëm rezultatet paraprake.

6. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të zhvillojë një proces për të analizuar informacionin në lidhje me ngjarjet të cilat i raportohen drejtpërdrejt atij, për të identifikuar risqet ndaj sigurisë në operim në aviacion të lidhura me ato ngjarje. Bazuar në atë analizë, ai do të përcaktojë ndonjë masë të duhur parandaluese ose korrigjuese të nevojshme për të përmirësuar sigurinë në operim.

7. Pas analizës së kryer në përputhje me pikën 6 të këtij neni, kur Autoriteti i Aviacionit Civil identifikon masat korrigjuese ose parandaluese, të nevojshme për trajtimin e mangësive aktuale apo potenciale të sigurisë ajrore të aviacionit, ai duhet që:

a) t'i zbatojë këto masa në kohën e duhur; dhe

b) të krijojë një proces për të monitoruar zbatimin dhe efektivitetin e veprimeve të ndërmarra.

8. Për çdo ngjarje apo grup ngjarjesh të monitoruar në përputhje me pikën 4 dhe 5, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të ketë të drejtë hyrjeje në analizat e bëra dhe duhet të vëzhgojë në mënyrë të përshtatshme masat e ndërmarra nga organizatat, për të cilat është përgjegjës.

Nëse Autoriteti i Aviacionit Civil arrin në përfundimin se implementimi dhe efektiviteti i masave të raportuara është i papërshtatshëm, për të trajtuar mangësitë aktuale ose potenciale të sigurisë, atëherë ai do të sigurojë ndërmarrjen dhe zbatimin e masave plotësuese nga organizata përkatëse.

9. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet ta përdorë informacionin e siguruar nga analizimi i ngjarjeve të raportuara për të identifikuar masat korrigjuese që duhet të ndërmerren, nëse ka, në kuadër të Programit Shtetëror të Sigurisë.

10. Për të informuar publikun mbi nivelin e sigurisë në aviacionin civil, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të botojë të paktën çdo vit një raport mbi rishikimin e situatës së sigurisë së operimeve në aviacionin civil.

11. Raporti mbi rishikimin e sigurisë duhet:

a) të përmbajë informacion mbi llojet e ngjarjeve të përmbledhura dhe të paidentifikuara nëpërmjet sistemit të tij të detyrueshëm dhe vullnetar të raportimit të ngjarjeve;

b) të identifikojë trendet;



c) të identifikojë masat që ka marrë.

12. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të botojë raporte të paidentifikuara të ngjarjeve dhe rezultatet e analizës së riskut.

Neni 14

Analiza e ngjarjeve dhe përcjellja në nivel të Bashkimit Evropian

1. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të bashkëpunojë me Komisionin, EASA dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare, të cilat marrin pjesë rregullisht në shkëmbimin dhe analizën e informacionit që gjendet në Bazën Qendrore Evropiane. Pa paragjykuar kërkesat e konfidencialitetit të përcaktuara në këtë rregullore, vëzhguesit mund të ftohen rast pas rasti, kur është e përshtatshme.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, Komisioni, EASA dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare bashkëpunojnë nëpërmjet një rrjeti të analistëve të sigurisë së aviacionit.

Rrjeti i analistëve të sigurisë së aviacionit do të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë së aviacionit, veçanërisht duke kryer analiza të sigurisë në mbështetje të Programit të Sigurisë së Aviacionit Evropian dhe Planit të Sigurisë së Aviacionit Evropian.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të mbështesë aktivitetet e rrjetit të analistëve të sigurisë së aviacionit.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar nëpërmjet EASA-s merr informacion në lidhje me rezultatet e analizës së informacionit të përmendur në paragrafin 1 në shqyrtimin vjetor të sigurisë të referuar në nenin 15 (4) të rregullores (EC) nr. 216/2008.

Neni 15

Konfidencialiteti dhe përdorimi i duhur i informacionit

1. Autoriteti i Aviacionit Civil dhe organizatat, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e duhur të informacionit të marrë, në përputhje me nenet 4, 5 dhe 10.

Çdo organizatë e themeluar brenda Republikës së Shqipërisë, duhet t'i përpunojë të

dhënat personale vetëm në masën e nevojshme, brenda qëllimit të kësaj rregulloreje.

2. Pa cenuar parashikimet në lidhje me mbrojtjen e informacioni të sigurisë, sipas rregullores në fuqi “Për investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil”, informacioni i marrë nga ngjarja e raportuar duhet të përdoret vetëm për qëllimin për të cilën ai është mbledhur.

Autoriteti i Aviacionit Civil nuk duhet të përdorë informacionin e ngjarjeve për:

a) përcaktimin e fajit ose përgjegjësisë;

b) ndonjë qëllim tjetër më shumë sesa ruajtja ose përmirësimi i nivelit të sigurisë ajrore.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të garantojë se do të bashkëpunojë me autoritetet e administrimit të drejtësisë, me anë të marrëveshjeve zyrtare mes tyre.

Neni 16

Mbrojtja e informacionit

1. Për qëllim të këtij neni, te “të dhënat personale” përfshihen emrat ose adresat e personave të veçantë.

2. Organizatat e themeluara në RSH duhet të sigurojnë që të gjitha të dhënat personale të cilat, krahas personave të përcaktuar në përputhje me nenin 6, u janë vënë në dispozicion edhe stafit, u janë dhënë vetëm kur ka qene absolutisht e nevojshme për të investiguar ngjarjet me qëllim rritjen e sigurisë ajrore.

Informacioni i paidentifikuar me të dhëna personale duhet të shpërndahet brenda organizatës, sipas rastit.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të sigurojë që asnjë e dhënë personale nuk duhet të regjistrohet në bazën e të dhënave kombëtare, të përmendur në nenin 6.

4. Një informacion i tillë i paidentifikuar, duhet t'u vihet në dispozicion të gjitha palëve të interesuara, për shembull, për t'iu lejuar atyre të kryejnë detyrat e tyre në lidhje me përmirësimin e sigurisë në aviacion.

5. Autoriteti i Aviacionit Civil nuk duhet të ndalohet nga marrja e masave të nevojshme për ruajtjen ose përmirësimin e sigurisë në aviacion.

6. Pa cenuar rregullat e aplikueshme të ligjit penal kombëtar, Autoriteti i Aviacionit Civil do



të distancohet nga fillimi i procedimeve për sa i përket shkeljeve jo me paramendim ose të paqëllimshme të ligjit, për të cilat bëhen me dijeni për shkak të raportimit, sipas neneve 4 dhe 5.

Nënparagrafi i parë i kësaj pike nuk do të zbatohet për rastet e përmendura në pikën 8. Autoritetet kompetente mund të ruajnë ose të miratojnë masa për të forcuar mbrojtjen e raportuesve ose personave të përmendur në raportimin e ngjarjes.

7. Nëse ka në proces, procedura disiplinore ose administrative, sipas legjislacionit në fuqi, informacioni që përmbajnë raportet e ngjarjeve nuk duhet të përdoret kundër:

- a) raportuesit; ose
- b) personave të përmendur në raportin e ngjarjeve.

Nënparagrafi i parë i kësaj pike nuk duhet të aplikohet për rastet e përmendura në pikën 8.

8. Me përjashtim të rasteve kur pika 8 zbatohet, punonjësit ose personeli i kontraktuar që raportojnë ose që janë përmendur në raportet e ngjarjeve, të mbledhur në përputhje me nenet 4 dhe 5, nuk do t'i nënshtrohen ndonjë paragjykimi nga ana e punëdhënësit të tyre ose nga organizatat për të cilën ofrohen shërbimet, në bazë të informacionit të ofruar nga raportuesi.

9. Mbrojtja sipas pikave 4, 5 dhe 7 të këtij neni nuk do të zbatohet për asnjë nga situatat e mëposhtme:

- a) në rastet e shkeljeve me dashje;
- b) në rastin e një neglizhence të dukshme, neglizhence serioze dhe të rëndë të një rreziku të dukshëm, neglizhence të përgjegjësisë profesionale, duke shkaktuar dëmtime të parashikueshme për një person ose pronë apo rrezikuar nivelin e sigurisë në aviacion.

10. Organizatat, pas konsultimeve me përfaqësuesit e stafit të saj, duhet të miratojnë rregullat e brendshme, të cilat përshkruajnë se si parimi “Kulturë e drejtë” (*just culture*), në veçanti parimi i përmendur në pikën 7, janë garantuar (promovuar) dhe zbatuar brenda kësaj organizate.

ANEKSI I

LISTA E KËRKESAVE TË APLIKUESHME PËR SKEMAT E RAPORTIMIT TË DETYRUESHËM DHE VULLNETARË TË NGJARJEVE

Shënim. Fushat e të dhënave duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar. Nëse për autoritetet kompetente nuk është e mundur për ta përfshirë këtë informacion, sepse informacioni nuk është ofruar (siguruar) nga organizata ose raportuesi, atëherë fusha e të dhënave mund të plotësohet duke vendosur “nuk e di”. Megjithatë, për t’u siguruar se informacioni i duhur është transmetuar, përdorimi i “nuk e di” duhet të shmanget, deri në një masë të mundshme dhe raporti kur është e mundur, duhet të plotësohet me informacion më vonë.

1. FUSHAT E PËRBASHKËTA TË TË DHËNAVE TË DETYRUESHME

Organizatat dhe autoritetet kompetente, kur regjistrojnë në bazën e tyre përkatëse të të dhënave, informacione mbi çdo raportim të detyrueshëm dhe vullnetar të ngjarjeve, duhet të sigurojnë që raportet e ngjarjeve të regjistruara në bazën e të dhënave të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- (1) Titulli
 - Titulli
- (2) Informacioni i dokumentit (dosjes)
 - Entiteti përgjegjës
 - Numri i dokumentit
 - Statusi i ngjarjes
- (3) Kur
 - Data (në UTC)
- (4) Ku
 - Shteti/zona e ngjarjes
 - Vendndodhja e ngjarjes
- (5) Klasifikimi
 - Klasa e ngjarjeve
 - Kategoria e ngjarjeve
- (6) Përshkrimi
 - Gjuha e përshkrimit
 - Përshkrimi
- (7) Ngjarjet
 - Tipi i ngjarjeve
- (8) Klasifikimi i riskut



2. FUSHAT SPECIFIKE TË TË DHËNAVE TË DETYRUESHME

2.1. Fushat e të dhënave lidhur me avionin

Organizatat dhe autoritetet kompetente, kur regjistrojnë në bazën e tyre përkatëse të të dhënave, informacione mbi çdo raportim të detyrueshëm dhe vullnetar të ngjarjeve, duhet të sigurojnë që raportet e ngjarjeve të regjistruara në bazën e të dhënave të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

(1) Identifikimi i avionit

- Shteti i regjistrimit
- Marka/modeli/seria
- Numri serial i avionit
- Regjistrimi i avionit
- Shenja thirrje

(2) Operimi i avionit

- Operatori
- Lloji i operimit

(3) Përshkrimi i avionit

- Kategoria e avionit
- Tipi i mekanizmit shtytës
- Klasifikimi i peshës (Grupimi sipas peshës)

(4) Historia e fluturimit

- Vendnisa e fundit
- Destinacioni i planifikuar
- Faza e fluturimit

(5) Moti

- Moti i përshtatshëm

2.2 Fushat e të dhënave lidhur me shërbimet e lundrimit ajror

Organizatat dhe autoritetet kompetente, kur regjistrojnë në bazën e tyre përkatëse të të dhënave, informacione mbi çdo raportim të detyrueshëm dhe vullnetar të ngjarjeve, duhet të sigurojnë që raportet e ngjarjeve të regjistruara në bazën e të dhënave të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

(1) Lidhja me MTA-në

- Kontributi i MTA-as
- Klasifikimi i ngjarjes bazuar në efektin që ka pasur në shërbimin e menaxhimit të trafikut ajror.

(2) Emri i njësisë së Shërbimit të Trafikut Ajror

2.2.1 Thyerja ndarjes minimale (*separation minima*)/humbje e ndarjes dhe shkelje e hapësirës ajrore - fushat e të dhënave

Organizatat dhe autoritetet kompetente, kur regjistrojnë në bazën e tyre përkatëse të të dhënave, informacione mbi çdo raportim të detyrueshëm dhe vullnetar të ngjarjeve, duhet të sigurojnë që raportet e ngjarjeve të regjistruara në bazën e të dhënave të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

dhënave, informacione mbi çdo raportim të detyrueshëm dhe vullnetar të ngjarjeve, duhet të sigurojnë që raportet e ngjarjeve të regjistruara në bazën e të dhënave të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

(1) Hapësira ajrore

- Tipi i hapësirës ajrore
- Klasa e hapësirës ajrore
- Emri i FIR/UIR

2.3. Fusha e të dhënave lidhur me aeroportin

Organizatat dhe autoritetet kompetente, kur regjistrojnë në bazën e tyre përkatëse të të dhënave, informacione mbi çdo raportim të detyrueshëm dhe vullnetar të ngjarjeve, duhet të sigurojnë që raportet e ngjarjeve të regjistruara në bazën e të dhënave të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

(1) Treguesi i vendndodhjes (sipas treguesve të ICAO-s)

(2) Vendndodhja në aeroport

2.4. Fusha e të dhënave të lidhura me dëmtime të avionit ose lëndime personale

Organizatat dhe autoritetet kompetente, kur regjistrojnë në bazën e tyre përkatëse të të dhënave, informacione mbi çdo raportim të detyrueshëm dhe vullnetar të ngjarjeve, duhet të sigurojnë që raportet e ngjarjeve të regjistruara në bazën e të dhënave të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

(1) Shkalla e rëndësisë

- Dëmtimi të mëdha
- Niveli i lëndimit

(2) Lëndime të personave

- Numri i lëndimeve në tokë (fatale, serioze, të lehta)
- Numri i lëndimeve në avionë (fatale, serioze, të lehta)

ANEKSI II

PALËT E INTERESUARA

(a) Lista e palëve të interesuara që mund të marrin informacionin bazuar në vendimet rast pas rasti ose sipas një vendimi të përgjithshëm sipas nenit 11 të po kësaj rregulloreje:

1. Prodhuesit. Dizenjuesit dhe prodhuesit e avionit, motorëve, helikave dhe pjesëve e pajisjeve të avionëve dhe shoqatat e tyre përkatëse; dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe përbërësve të Menaxhimit të



Trafikut Ajror (MTA); dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe përbërësve të Shërbimeve të Lundrimit Ajror (SHLA), dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe pajisjeve të përdorura në pjesën ajrore të aerodromeve.

2. Mirëmbajtja. Organizatat e përfshira në mirëmbajtje ose kontroll të jashtëm fizik të avionëve, motorëve, helikave dhe pjesëve e pajisjeve të avionëve; në instalimin, modifikimin, mirëmbajtjen, riparimin, revizionim, kontrollin e fluturimit ose inspektimin e shërbimeve ndihmëse standarde të lundrimit ajror ose mirëmbajtjen, revizionin e sistemeve të pjesës ajrore të aerodromeve, përbërësve dhe pajisjeve.

3. Operatorët. Linjat ajrore, operatorët e avionëve, shoqatat e linjave ajrore dhe operatorëve, operatorët e aerodromeve dhe shoqatat e operatorëve të aerodromeve.

4. Ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror dhe siguruesit e funksioneve specifike të Menaxhimit të Trafikut Ajror.

5. Ofruesit e shërbimeve të aerodromeve. Organizatat e ngarkuara me shërbimet në tokë të aeroporteve, përfshirë furnizimin me lëndë djegëse, përgatitjen e dokumentacionit, ngarkimin, pastrimin e akullit (*de-icing*) dhe rimorkimin e avionëve në një aerodrom, si dhe operimet e shpëtimit dhe zjarrfikëset ose shërbimet e tjera të emergjencave.

6. Organizatat e trajnimit në aviacion.

7. Organizatat e shteteve të huaja, joanëtare të ZPEA-së. Autoritetet shtetërore të aviacionit dhe organizatat e investigimit të aksidenteve nga shtetet e huaja, jo anëtare të ZPAE-së.

8. Organizatat ndërkombëtare të aviacionit.

9. Kërkim. Labororë kërkimi publik ose privatë, qendra ose entitete ose universitete të angazhuara në kërkime ose studime për sigurinë ajrore në aviacion.

(b) Lista e palëve të interesuara që mund të marrin informacion, bazuar në vendimet rast pas rasti, në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje:

1. Pilotët (mbi baza personale)

2. Kontrollorët e trafikut ajror (mbi baza personale) dhe stafi tjetër i MTA/SHLA-së që kryen detyra që lidhen me sigurinë ajrore.

3. Inxhinierë/teknikë/personel elektronik për sigurinë në trafikun ajror/menaxherë aviacioni (ose aerodromi) (mbi baza personale).

4. Organizata përfaqësuese profesionale të stafit që kryen detyra lidhur me sigurinë ajrore.

ANEKS III

KËRKESA PËR MARRJEN E INFORMACIONIT NGA BAZA E TË DHËNAVE EVROPIANE DHE KOMBËTARE DO TE JETË SIPAS FORMËS SË MËPOSHTËME:

1. Emri:

Funksioni/pozicioni:

Shoqëria:

Adresa:

Tel:

E-mail:

Data:

Natyra e biznesit:

Kategoria e palës së interesuar (shiko aneksin II të kësaj rregulloreje):

2. Informacioni i kërkuar (lutemi të jeni sa më specifik të jetë e mundur; duke përfshirë periudhën/datën përkatëse për të cilën jeni të interesuar):

3. Arsyeja për kërkesën:

4. Qëllimi për të cilin do ta përdorni informacionin:

5. Data sipas të cilës kërkohen të dhënat:

6. Forma e plotësuar duhet të dërgohet me e-mail, tek: (pika e kontaktit)

7. Akses të informacionit

Pika e kontaktit nuk është i detyruar të ofrojë çdo informacion të kërkuar. Këtë mund ta bëjë vetëm nëse është i sigurt që kërkesa është bërë në përputhje me këtë urdhër (ose referencën evropiane sipas rastit). Kërkuesi merr përsipër që ai dhe organizata e tij do ta përdorë informacioni



e marrë vetëm për qëllime që kanë përshkruar në pikën 4 të këtij aneksi. Duhet marrë në konsideratë që informacioni i siguruar në bazë të kësaj kërkesë, është vënë në dispozicion vetëm për qëllimet e sigurisë dhe jo për qëllime të tjera, përfshirë përcaktimin e fajit ose të përgjegjësisë ose qëllime tregtare.

Kërkuesit nuk i lejohet t'i zbulojë askujt të dhënat e marra pa miratimin me shkrim të pikës së kontaktit.

Mosplotësimi i kërkesave të mësipërme mund të çojë në mohim të aksesit për informacion të mëtejshëm nga baza e të dhënave kombëtare, si dhe në ndonjë sanksion sipas rastit.

8. Data, vendi dhe firma:

VENDIM

Nr. 4, datë 17.4.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 2, DATË 27.3.2019, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA E PARË, PËR VITIN 2019, GRANTET “ARSIMI BAZË”, “ARSIMI I MESËM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve,

VENDOSI:

1. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pas pikës 3, të vendimit nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, shtohen pikat, si më poshtë vijon:

“... ”

4. Diferenca mes vlerës së projektit me vlerën e kontratës, nëse ka një të tillë, pas prokurimit publik, do t'i zbritet proporcionalisht vlerës së bashkëfinancimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe vlerës së financimit me burim grantin “Arsimi”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Diferenca mes vlerës së projektit me vlerën e kontratës, nëse ka një të tillë, pas prokurimit publik, nga projektet sipas këtij vendimi dhe nga projekte të tjera të autoriteteve kontraktuese, të financuara nga burime të tjera financimi të tyre, të rialokohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbulimin e vlerës së bashkëfinancimit, të autoritetit kontraktues për vitin 2019, për projektet sipas këtij vendimi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes degëve të thesarit, monitoron zbatimin e kësaj pike të vendimit.

6. Autoritetet kontraktuese, në buxhetin korent dhe atë të vitit 2020 dhe në detajimin e planit të investimeve, me përparësi, të financojnë vlerën e bashkëfinancimit për projektet e investimeve në proces, me burim financimi Fondin për Zhvillimin e Rajoneve. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe prefektët monitorojnë zbatimin e kësaj pike të vendimit.

7. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1, të vendimit nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, brenda një jave nga përfundimi i afatit, sipas pikës 3, të vendimit nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, të informojnë sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për nisjen e procedurave të prokurimit publik për këto projekte.

“... ”

3. Pikat 4 dhe 5, të vendimit nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, rinumërohen përkatësisht në pikat 8 dhe 9.

4. Ngarkohen ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe prefektët për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETAR
Erion Braçe

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar
Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Brendshëm	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar

Tabela 1: Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, rreshtat 1, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 21, 24, 25, 26, 29, 30, 31, 32, 33, kolona me emërtimin “Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2019 (në lekë)”, dhe qeliza e totalit të vlerës së bashkëfinancimit për vitin 2019, ndryshojnë, si më poshtë vijon:

“**Tabela 1.** Lista e projekteve të reja, thirrja e parë për vitin 2019, grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, me cikël zbatimi 2019-2020”

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit nga FZHR për vitin 2019 (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV (në lekë)		
					%	Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2019 (në lekë)
		QARKU BERAT					
1	Bashkia Kuçovë	Rikonstruksion i shkollës “18 Tetori”, Kuçovë	76,911,627	21,535,256	30	23,073,488	8,075,721
		QARKU KUKËS					
4	Bashkia Tropojë	Shkolla “Asim Vokshi”, palestër dhe terrene sportive dhe sisteme të jashtme në gjimnazin “Asim Vokshi”	59,919,542	21,571,035	10	5,991,954	5,991,954
5	Bashkia Tropojë	Rikonstruksion i shkollës “Tinka Kurti”, NJA Lekbibaj	29,488,437	13,269,797	10	2,948,844	2,948,844
6	Bashkia Kukës	Ndërtim i terreneve sportive të shkollës, Shtigen	15,590,893	5,456,813	30	4,677,268	1,637,044
		QARKU Durrës					
7	Bashkia Shijak	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “Adem Sabli”, fshati Borakë	73,231,332	19,772,460	10	7,323,133	7,323,133
8	Bashkia Krujë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim palestere, Thumanë	70,671,320	19,787,970	30	21,201,396	7,420,489
		QARKU ELBASAN					
9	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Jorgji Dilo”, Elbasan	124,187,521	21,732,816	50	62,093,761	21,732,816
12	Bashkia Librazhd	Shtesë anësore 3 kate dhe ndërtim palestere për shkollën 9-vjeçare	82,881,472	26,107,664	10	8,288,147	8,288,147



		“Vilson Blloshmi”, Librazhd					
		QARKU FIER					
13	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Lushnje	49,881,342	9,976,268	50	24,940,671	8,729,235
14	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion i ambjenteve të shkollës së bashkuar “Thanas Bozo” dhe ndërtim palestre, Kolonjë	78,525,669	15,705,134	50	39,262,835	13,741,992
15	Bashkia Roskovec	Rikonstruksion godine dhe ndërtim palestre, gjimnazi “Adem Vrapit”	99,120,026	31,222,808	10	9,912,003	9,912,003
16	Bashkia Divjakë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore 2 kate, shkolla e mesme e bashkuar, “Mihal Nako” fshati Fier, Seman, Gradisht	81,681,368	20,011,935	30	24,504,410	8,576,544
17	Bashkia Divjakë	Ndërtim kopshti me drekë, Cermë, Sektor	67,261,984	16,479,186	30	20,178,595	7,062,508
18	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës së mesme “Jovan Ndreko”, Libofshë	26,241,404	6,560,351	50	13,120,702	4,592,246
19	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Penelopi Pirro”	41,793,855	8,358,771	50	20,896,928	7,313,925
		QARKU KORÇË					
21	Bashkia Pogradec	Rehabilitim i shkollës së mesme “Gjergj Pekmezi”	77,497,937	18,986,995	30	23,249,381	8,137,283
24	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, 3 kate dhe shtesë për palestër	50,000,000	14,000,000	30	15,000,000	5,250,000
		QARKU LEZHË					
25	Bashkia Kurbini	Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare “Mark Trothi”, Kurbini	97,639,380	27,339,026	30	29,291,814	10,252,135
26	Bashkia Lezhë	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar, Ishull Lezhë dhe ndërtim palestre	81,170,727	14,204,877	50	40,585,364	14,204,877
		QARKU SHKODËR					
29	Bashkia Malësi e Madhe	Rikonstruksion i shkollës “Vasil Shanto”, fshati Vrakë	42,194,347	11,814,417	30	12,658,304	4,430,406
30	Bashkia Fushë Arrëz	Ndërtim i palestrës dhe ambjenteve sportive, shkolla e mesme “70 Vjetori i Pavarësisë”	49,554,052	22,299,323	10	4,955,405	4,955,405
		QARKU TIRANË					
31	Bashkia Kavajë	Rindërtim i shkollës 9- vjeçare Golem, Kavajë	142,515,637	39,904,378	30	42,754,691	14,964,142
32	Bashkia Vorë	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë e shkollës “Vajdin Lamaj”, Domje	88,717,281	22,525,730	30	26,615,184	9,315,315
		QARKU VLORË					
33	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkollës “24 Maji” dhe ambjenteve sportive, Vlorë	99,578,242	19,915,648	50	49,789,121	17,426,192



Shënim:

1. Totali i vlerës së bashkëfinancimit për vitin 2019, bëhet si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit nga FZHR për vitin 2019 (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV (në lekë)		
					%	Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2019 (në lekë)
		TOTALI					279,956,885

2. Në fund të pikës 4, të shënimeve të tabelës 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 2, datë 27.3.2019, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, të shtohet togfjalëshi:

“bashkëfinancim i cili për projektet me nr. rendor 1, 6, 8, 9, 13, 14, 16, 17, 18, 19, 21, 24, 25, 26, 29, 31, 32 dhe 33 është, për vitin 2019, në masën 35% të vlerës së plotë të bashkëfinancimit dhe për vitin 2020, në masën 65% të vlerës së plotë të bashkëfinancimit”.

3. Për projektet me nr. rendor 4, 5, 7, 12, 15 dhe 30 korrektohet gabimi shifror “i vlerës së bashkëfinancimit për vitin 2019”, sipas tabelës më sipër.

VENDIM Nr. 53, datë 3.4.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR KRITERET STANDARDE MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT DHE FURNIZIMIT TË RRJETEVE TË GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe të nenit 16, pika 18; nenit 48, pika 5; nenit 53 pika 5; nenit 89, pika 1 dhe 7; nenit 89, nenit 94 pikat 5 dhe 8 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 3.4.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”, konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 16, pika 18, ERE ka kompetencën të hartojë *Draft-Rregulloren për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror*.

- Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, duke dhënë orientim në lidhje me kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror.

- Duke qenë se kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit të sektorit të energjisë elektrike janë tashmë në një fazë të avancuar në sektorin e gazit natyror në nivelin e BE-së dhe Komitetit të Energjisë (EnCom), lind nevoja të miratohen nga ERE edhe kërkesat për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror, duke ndjekur të njëjtën rrugë.

- Këshilli i Rregullatorëve Evropianë të Energjisë (CEER), për herë të parë e përfshiu gazin natyror në raportin e tij të 6-të BENCHMARKING, mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike dhe gaz në vitin 2016, ndërsa raporti i parë në nivel EnCom, “Cilësia e shërbimeve të shpërndarjes dhe furnizimit të gazit në komunitetin e energjisë”, u botua në nëntor 2018.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit në ERE dhe të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 54, datë 3.4.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE
PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2019 PËR
SHOQËRINË OST SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 60, si dhe nenit 20, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të neneve 6, 7, 8, 10 dhe 11, të “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 135, dt. 6.9.2017, nenit 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.4.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 19, datë 15.2.2019, lidhur me *“Fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve për vitin 2019 për shoqërinë OST sh.a.”*,

Konstatoi se:

- “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., me shkresën nr. 1217 prot, datë 14.2.2019, ka paraqitur pranë ERE-s “Planin e investimeve për vitin 2019”.

- Me urdhrin nr. 19, datë 15.2.2019, është ngritur grupi i punës për të analizuar materialin e dërguar nga shoqëria OST sh.a.

- Në shkresën nr. 1413, datë 22.2.2019, shoqëria OST sh.a., ka dërguar në ERE “Programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2019” me miratimet përkatëse nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., ku parashikohen investimet që OST sh.a. do të kryejë me fondet e veta dhe ato të huajtura.

- Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria OST sh.a., referuar me sa parashikuar nga “Rregullorja e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017 të Bordit të ERE-s, vërehet:

- **neni 8, pika 2 dhe pika 4 - nuk është plotësuar** (mungon informacioni, i cili përcakton ndër të tjera se investimet e parashikuara për vitin 2019 duhet të shoqërohen me analizën kosto-përfitim, si dhe çdo investim i parashikuar duhet të shoqërohet me relacione shpjeguese);

- **neni 11, pika 1 - nuk është plotësuar** (plani i investimeve për vitin 2019 duhej të ishte dërguar së bashku me aplikimin për tarifën e transmetimit të vitit 2019. Pavarësisht kësaj, gjatë procesit të përcaktimit të tarifës së transmetimit, ERE mori në konsideratë në llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) dhe investimet e kapitalizuara dhe parashikimin e investimeve të OST sh.a. për vitin 2019 (në vlerën totale prej 5654 milionë lekë, prej të cilave 428 milionë lekë figurojnë me grante) bazuar në informacionet e vëna në dispozicion gjatë këtij procesi. Diferenca prej 10 milionë lekësh midis planit të investimeve për vitin 2019 dhe vlerës së marrë në konsideratë në përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019 është minimale dhe nuk influencon në mbulimin e investimeve nëpërmjet tarifës për vitin aktual);

- **neni 11, pika 4 dhe pika 6 - nuk është plotësuar** (mungon paraqitja e planit të investimeve; nuk është dokumentuar konsultimi me palët e interesuara konform rregullores përkatëse);

- investimet e OST sh.a. për vitin 2019 me fondet e huajtura konsistojnë:



Parashikimi i programit te Investimeve te OST Sha per vitin 2019							
Nr	Pershkrimi i projektit	Vlera e fondeve te angazhuara	Per tu disbursuar nga kredia		Per tu financuar nga OST Sha		Grant
		Valute (Euro)	ne mln Leke	Valute (Euro)	ne mln Leke	Valute (Euro)	
1	Zgjerimi i sistemit te matjes per konsumatoret e kualifikuar*	18,687,500	1,545,975	207	386,494	52	
2	1) L 220kV Tiranë-Rrashbull, 2) Fuqizimi i Rrjetit Unazor 110kV te qytetit te Tiranës (kablur) dhe ndertimi i N/Statdonit 220/110 kV (opsion 400/110kV) Tirana 3- Konsulenca Fichtner	40,000,000	10,000,000	1,338			
3	1) Nderimi i Linjes se Interkoneksionit 400 kV Elbasan-Bitola (Maqedoni), 2) N/Statcioni i Ri 400 kV Elbasan 3; 3) Linja Elbasan Fier dhe 4) Nenstatcioni Fier	64,851,000	9,360,000	1,253			3,196,000
4	Kosto Lokale					50	
5	Investimet me fondet e veta					2,341	
6	Totali	174,957,037	20,905,975	2,798	386,494	2,439	3,196,000
							428



Investimet e OST sh.a për vitin 2019 me fondet e veta konsistojnë:

Nr	Objekti i prokurimeve (Investime)	Fondi i parashikuar	Fondi i parashikuar	Fondi i Përafërt	Fondi i Përafërt
Zëra që përfshihen vetëm në fondin e përafërt të pagesave					
1	Linja e re 220 kV Burrel- Peshkopi Plus 1(një) takt 220 kV Lot 1			361,923,293	361,923,293
	Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400kV 120MVar, Sistemit Total te motorimit te tij, Konfigurimin ne sistemin SCADA, Furnizim dhe vendosjen e Traktit 400kV ne N/st Zembak si dhe kryerja e te gjitha punimeve civile ne lidhje me kete projekt.			246,937,810	246,937,810
3	Ndertimi i linjes 110kV N/st Sallmone- Gjiri i Lalezit			118,870,102	118,870,102
4	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit F.Arrez			102,012,884	102,012,884
5	Rikonstruksioni i linjave 110kV Laç 2-Ura e Matit dhe Skuraj Ura e Matit			100,000,000	100,000,000
6	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Jagodine			88,991,480	88,991,480
7	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Prenjas			69,507,185	69,507,185
8	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Kajan			68,661,556	68,661,556
9	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Ibe			63,208,262	63,208,262
10	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Plasmas			61,854,710	61,854,710
11	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Librazhd			54,946,077	54,946,077
12	Lyerja e shtyllave te transmetimit te TL			49,000,000	49,000,000
13	Rikonstruksioni i anes 110kV te nenstacionit Rubik			45,308,324	45,308,324
	Ngritja i nje sistemi per lokalizimin e avarive ne linjat e transmetimit. Blerje, instalim, konfigurim i serverit per analizatoret e vajit te AT-ve dhe celsave te nivelit 110kV e lart			38,000,000	38,000,000
14					
15	Ndertimi i Magazines prane N/stacionit Tirana 2			29,202,920	29,202,920
16	Mbikqyrja e punimeve per objektet e reja			27,637,331	27,637,331
	Plotesimi dhe venia ne pune e Traktit 110kV ne nenstacionit Fier per N/stacionin 110/20 kV te OSHEE+ trainimi i personelit Inxhiniero- teknik te DSHMT			24,952,000	24,952,000
17					
18	Nderhyrje ne linjat e transmetimit 110kV te rajonit te Njesise Operative Fier.			18,000,000	18,000,000
	Furnizim vendosje e traktit te linjes 110-13 ne N/stacionin Lac 1 dhe punime civile			11,704,481	11,704,481
19					
20	Sistemimi i problematikave te drenazimit ne Nenstacionit Tirana 2			5,169,678	5,169,678
	Ndrerhyrje emergjente ne linjat e TL per monitorimin dhe rritjen e sigurise se rrjetit te transmetimit		80,000,000		64,000,000
21					
	Totali 1		80,000,000	1,585,888,093	1,649,888,093
	Zerat qe perfshihen ne rregjistrin e prokurimeve dhe fondin e pagesave				
22	Ndertimi i N/st 220/110 kV, 1x120 MVA Shumat(Peshkopi)	700,000,000	700,000,000	140,000,000	140,000,000
23	Linja 110kV N/st Fiber-Librazhd	450,000,000	450,000,000	70,000,000	70,000,000
	Punime per perfundimin e linjes kabllore 110kV Tirana-Selite dhe lidhja me nenstacionin 110/20kV Kombinat	100,000,000	100,000,000	83,000,000	83,000,000
24					
25	Furnizim dhe vendosje e celave rezerve 20kV dhe 35kV per N/st Tirana1 dhe pjese kembimi per keto celsa	45,000,000	45,000,000	45,000,000	45,000,000
	Blerja e nje trakti portativ 110kV, si rezultat i punimeve gjate rehabilitimit te impianteve 110kV te nenstacioneve 110/TM kV	35,000,000	35,000,000	35,000,000	35,000,000
26					
27	Blerje Paneleve te mbrojtjes dhe komandimit per trakte 110 kV	50,000,000	50,000,000	50,000,000	50,000,000
28	Nderhyrje per rastet emergjente ne linjat e TL	40,000,000	40,000,000	40,000,000	40,000,000
29	Blerje materiale per nenstacione	100,000,000	100,000,000	100,000,000	100,000,000
	Blerje materiale dhe vegla pune te sigurimit teknik si dhe pajisjet(laborator)per testimin e mjeteve te sigurimit teknik.	30,000,000	30,000,000	30,000,000	30,000,000
30					
31	Upgrade i sistemit te kontrollit dhe BCU te N/st 220kV Koplik	36,000,000	36,000,000	36,000,000	36,000,000
	Upgrade Hardware-Software i sistemit te kontrollit te nenstacionit 400/220/110kV Tirana 2	38,000,000	38,000,000	38,000,000	38,000,000
32					
33	Blerje programi kompjuterik per analizen e rrjetit	12,000,000	12,000,000	12,000,000	12,000,000
	Blerjen e dy licensave USB per program kompjuterik PSS©E per analizen e rrjetit	12,000,000	12,000,000	12,000,000	12,000,000
34					
	Totali 2	1,648,000,000	1,648,000,000	691,000,000	691,000,000
	Totali i Investimeve	1,648,000,000	1,728,000,000	2,276,888,093	2,340,888,093



- **neni 7, pika 2 - nuk është plotësuar** (OST sh.a. duhet të kishte dërguar në ERE raportin vjetor të zbatimit të planeve të investimeve të vitit paraardhës, duke treguar ecurinë e investimeve të planifikuara dhe duke siguruar shpjegim për çdo ndryshim në plan. Raporti vjetor do të dorëzohet jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të periudhës në të cilën zbatohet plani i investimeve. Përmendim faktin se, për planin e investimeve për vitin 2018 të OST sh.a., ERE nuk është shprehur me një vendimmarrje, për arsye të mungesës së kërkesës së shoqërisë për miratimin e planit të investimeve. Pavarësisht kësaj, në përcaktimin e tarifës së transmetimit për vitin 2019 u morën në konsideratë investimet e kapitalizuara sipas informacioneve të vëna në dispozicion nga OST sh.a. gjatë këtij procesi në vlerën 2,479 milionë lekë. Megjithatë plani i investimeve të OST sh.a. gjen fillimisht miratim nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, për të miratuar planin e investimeve për vitin 2019, konform legjislacionit në fuqi, OST sh.a. duhet të paraqesë kapitalizimin e investimeve për vitin 2018, krahasuar me planin e investimeve për vitin 2018 të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.

- Në programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2019 miratuar me vendimin nr. 59, datë 15.1.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. janë paraqitur shpjegime në lidhje me disa nga zërat e parashikuar në planin e investimeve për vitin 2019 me fondet e vetë shoqërisë, si dhe me fondet e huajtura.

- Nga analiza e materialeve të dërguara me shkresat e sipërcituara, vlera e parashikuar në zërat e investimeve për vitin 2019 është e njëjtë me atë të miratuar me anë të vendimit nr. 59, datë 15.1.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të “OST” sh.a. prej 5,664 milionë lekë me fondet e veta, si dhe me fondet e huajtura.

- Miratimi i planit të investimeve është një proces mjaft i rëndësishëm, edhe pse i vonuar në kohë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019 për shoqërinë “OST” sh.a., me kusht që shoqëria të depozitojë

në ERE jo më vonë se 15 ditë nga marrja në dijeni e këtij vendimi, aplikimin sipas kushteve të parashikuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017 të Bordit të ERE-s dhe të plotësojë mangësitë e konstatuara në këtë vendim.

2. OST sh.a. të depozitojë pranë ERE-s “Planin e investimeve për vitin 2019”, të rishikuar, në përputhje me gjendjen financiare dhe likuiditetin e shoqërisë, duke renditur investimet sipas prioritetit.

3. OST sh.a. të depozitojë për shqyrtim në ERE “Planin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare, 2015-2025”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 212, datë 28.12.2017, të përditësuar, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe standardeve të ENTSO-E.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë shoqërinë OST sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit në ERE dhe të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 55, datë 3.4.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar, me vendimin e



Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018, “Mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit””; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 3.4.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin mars 2019,

Konstatoi se:

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 7096 prot., datë 27.3.2019 paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2019. Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sh.a. kërkon që çmimi i shitjes së energjisë

elektrike të klientët e FMF-së për muajin mars 2019 të jetë 13.43 lekë/kWh.

- OSHEE sh.a. shprehet se për llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ka aplikuar formulën për llogaritëse të nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018.

Llogaritjet e OSHEE sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2019 dhe llogaritjet tona për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin mars 2019, sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Raporti i OSHEE sh.a. në lidhje me çmimin e llogaritur për FMF për muajin Janar 2019				
Mars 2019				
		Aplikimi Oshee		Propozimi i ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparësi	Leke/kWh	9.12	9.09
b	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.27	0.27
c	Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	9.39	9.36
d	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
e	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
f	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.5	1.5
Çmimi i energjisë (c+d+e+f)		Leke/kWh	13.43	13.40

- OSHEE sh.a. për muajin mars 2019 ka zhvilluar tri procedura për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar. Përkatesisht dy prej tyre janë realizuar në datën 8 mars dhe një në datën 11 mars 2019. OSHEE sh.a. shprehet se përcaktimi i çmimit maksimal të blerjes për muajin mars 2019 prej 9.12 lekë/kWh, i përket energjisë me çmimin më të lartë nga shoqëritë NOA sh.p.k., loti 2 dhe “Ayen Energy Trading” sh.p.k., loti 1, realizuar në datën 8.3.2019, për sasinë totale prej 1,120 MWh me një vlerë prej 10,188,931.2 lekë.

- Nga informacioni i OSHEE sh.a., mbi procedurat e blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar, rezulton se çmimi maksimal i blerjes është **73 EUR /MWh** për

sasinë 1,120 MWh nga shoqëritë ofertuese NOA sh.p.k. dhe “Ayen Energy Trading” sh.p.k. në fazën përfundimtare të negociimit në datën 8.3.2019, për periudhën 11.3.2019-17.3.2019 dhe fashën orare 7:00-23:00.

- Nga analiza e informacionit mbi procedurat e blerjes së energjisë, data e realizimit të procedurës kur u realizua çmimi më i lartë i blerjes është në datën 8.3.2019. Sipas publikimit në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë në këtë datë rezulton se kursi i këmbimit është 124.57 Euro/Lekë, sikurse paraqitur më lart.

- Ashtu si dhe në vendimmarrjet e deritanishme për muajt respektivë, ERE merr në konsideratë vetëm kursin zyrtar të këmbimit të publikuar sipas Bankës së Shqipërisë për ditën



kur është realizuar çmimi më i lartë i blerjes. E njëjta praktikë do të ndiqet edhe për muajin mars, në të cilin rezultoi kursi 124.57 Euro/Lekë.

- Lidhur me përcaktimin e Kostove Administrative të Fuqizuesit të Mundësisë së Fundit, OSHEE sh.a. ka paraqitur vlerësimin prej 1,79 lekë/kWh.

- Shoqëria vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktivitetit të Furnizimit dhe Shpërndarjes dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostot e disbalancave për klientët e FMF-së.

- Në këto kushte mendojmë se për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) është e arsyeshme të pranojmë koston për njësi prej **1.79 lekë/kWh** të paraqitur nga OSHEE sh.a.

- OSHEE sh.a., sikurse edhe në periudhat paraardhëse, vazhdon të mos përcaktojë kostot e disbalancave për klientët e FMF-së dhe nuk deklaron nëse i faturon këta klientë për këto kosto.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a. për vitin 2019”, është 0.75 lekë/kWh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 268, datë 21.12.2018 të Bordit të ERE-s, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kWh.

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përllëgaritëse, rezultoi që çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është **13.40 lekë/kWh** për muajin mars 2019.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 13.40 lekë/kWh për muajin mars 2019.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit, në ERE dhe të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 56, datë 3.4.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
TRANSPOZIMIN E RREGULLORES
2017/459, TË MIRATUAR ME VENDIMIN
NR. 2018/06/PHGL-ENC, “MBI
THEMELIMIN E KODIT TE RRJETIT
PËR MEKANIZMAT E ALOKIMIT TË
KAPACITETEVE NË SISTEMET E
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikimeve të vendimit nr. 2018/06/PHGL-EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 3.4.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi fillimin e procedurës për transpozimin e rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr. 2018/06/PHGL-EnC, “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”,



Konstatohet se:

- Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “ALBGAZ” sh.a., me shkresën nr. 18 prot., datë 18.2.2019, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE “Kodin e Rrjetit për mekanizmat e ndarjes së kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”, të përditësuar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ERE ka kompetencën të miratojë “Kodin e rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”.

- Ky Kod do të shqyrtohet dhe miratohet si detyrim i sa më poshtë:

- Shqipëria është anëtare e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006.

- Parashikimet e Rregullores (të BE-së) nr. 715/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës.

- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2017/459, të datës 16 mars 2017.

- Vendimit nr. 2018/06/ PHGL-EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë.

- Parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

- Licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror.

- Licencimin shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror.

- Certifikimin paraprak të Operatorit të Kombinuar të gazit natyror “ALBGAZ” sh.a. në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC.

- ALBGAZ sh.a. gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit Evropian të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.

- Ky Kod është hartuar dhe përshtatur në respektim të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/06/ PHGL-EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, duke dhënë orientim në lidhje me mekanizmat e alokimit të

kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror.

- Në referencë të vendimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë PHLG-ENC, kjo rregullore do të bëhet e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa ndryshime në strukturën e tekstit të Rregullores (EU) nr. 2017/460, përveç përkthimit dhe përshtatjes të bërë sipas këtij vendimi.

- Në kontekst të zbatimit të përgjegjësi të monitorimit të zbatimit, Sekretariati do të monitorojë dhe analizojë, se si operatorët e sistemit të transmetimit, kanë zbatuar këtë Rregullore:

1. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'i dorëzojnë Sekretariatit të Komunitetit të energjisë, të gjitha informacionet e kërkuara nga Sekretariati për të përmbushur detyrimet e tij sipas paragrafit 1, jo më vonë se 9 muaj pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj Rregulloreje.

2. Konfidencialiteti i informacionit komercialisht të ndjeshëm ruhet nga Sekretariati.

3. Jo më vonë se dy vjet pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj rregulloreje, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të raportojë mbi kushtet e parashikuara në kontratat për produkte të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, duke pasur parasysh efektet e tyre në përdorimin efikas të rrjetit dhe integrimin e tregjeve të gazit të Komunitetit të Energjisë. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të mbështetet në vlerësimin e tij nga Autoritetet Kombëtare Rregullatore dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transpozimin e Rregullores 2017/459, të miratuar me vendimin nr. 2018/06/PHGL-EnC, “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit, në ERE dhe të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë